

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7815 E shtunë 9 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Dje**  
në "Deutsche Welle"

Në mbështetje të grupit të së Ma-  
njës Evropiane dhe të së Gjelbrës  
Nordike në Parlamentin Evropian, në  
Bruksel u mbledhën për të kërkuar  
mbështetje për ...  
Vijon në faqen 20

Nga VIRTYT GACAFERRI

Pse qeveritë e Ballkanit  
dëmtojnë ambientin për HEC-et



**Opinion**  
Ditës

Në shqiptarët kemi një raport të  
veçant me festat. Ne vzhdojmë  
të bashkëjetojmë me ngutin për t'i  
nxjerrë ditës së pushimit zyrtar në  
kalendar gjithë ...  
Vijon në faqen 21

Nga LORENC VANGJELI

Ndjesë, në gjuhë  
dhe gjithmonë!



Reportazhi nga Tirana i gjigandit britanik

## BBC: Shembja e Teatrit i shkurton karrierën, Rama: Varrezë historike

Kronika speciale/ Kryeministri: Jo çdo gjë e jetër mirëmbahet. "Aleanca": Teatri ka vlera

Teatri Kombëtar dhe Teatri Kombëtar Eksperimental, zënë vend edhe në lajmet e BBC. Gjigandi britanik BBC e ka cilësuar shembjen e godinave si çështjen që po fillon t'i kushtojë karrigen kryeministore një ish-artisti. Një gazetar ka ardhur në Tiranë për të përfshirë në një kronikë 5 minutëshe, citime nga kryeministri Edi Rama, ish-deputetja ...  
Në faqen 19

## UDHEZIMI/ OPOZITA DO TE IDENTIFIKOJE EMRAT E PJESEMMARRSVE NE PROTESTE

# PD, GRUPE MONITORIMI PER 16 MARSIN. BE: DIALOGONI

Presidenti i PPE, Daul: Ka shumë punë për të bërë për zgjedhje të lira.  
Soreca: Partitë të marrin pjesë në zgjedhje. Deputeti gjerman: Bashkëpunoni



(Në foto) Keshilli Kombëtar i PD

Në faqen 2-3

**KANDIDATET E PS**  
Turi në rrethe, Rama konfirmon Armando Subashin për kryebashkiak në Fier  
Në faqen 4

**ISH-DEPUTETI I PD**  
Ervin Salianji thirret në prokurori: Denoncova trafikantin, tani jam i pandehur  
Në faqen 6

**PROCEDURA**  
Flet specialisti: Si merret leja e qëndrimit në Greqi kur ikën nga vendi  
Në faqen 7

**"BLUETOOTH"**  
Jori Delli, modelja dhe moderatorja shqiptar në Itali: Vështirësia e suksesit  
Suplement

### MAQEDONIA E VERIUT



Menduh Thaçi dënohet me 3 vite burg për zgjedhjet me probleme në 2013

Në faqen 12

LISTA E TRETE/ 6 mijë familjet që iu njihet e drejta për të marrë paratë

## Dosjet e '93-2013, pronarët që kompensohen

Emrat, Agjencia e Pronës: Si ndahet fondi financiar, kush përfiton

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën 6 611 me pronarët që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të



gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilën dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje të cilave Agjencia e Trajtimit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të ...  
Në faqen 9-11

# KRIZA POLITIKE

## PROTESTA

Nën monitorim listat e degëve për pjesëmarrësit dhe personat e angazhuar

# Protesta, PD ngre strukturë të posaçme për përgatitjet e 16 marsit

### Grupet e punës verifikojnë emrat e protestuesve

Valentina Madani

Opozita e bashkuar i ka përgjendruar enërgjitetë e saj për protestën masive që është lajmëruar të zhvillohet në datën 16 mars para kryeministrit në orën 11:00. Për këtë qëllim mësohet se Partia Demokratike ka ngritur një strukturë të posaçme për organizimin në bazë, ndërsa kryetari Lulzim Basha ka firmosur udhëzimin për mënyrën se si do të kryhen të gjitha përgatitjet, duke ia deleguar si detyrë kryetareve të degëve dhe të deleguarve në çdo qark. Basha, kërkoi që strukturat të intensifikojnë takimet me qytetarët për të bindur që të marrin pjesë në protestë. Pas shpërndarjes së udhëzimit në të gjitha degët e vendit, të premtën në selinë e Partisë Demokratike u zhvillua një takim i sekretariatit organizativ, për të ngritur një strukturë tjetër: Grupet e Monitorimit. "Grupet e Monitorimit janë përgjegjëse për të ndihmuar Degët që kanë nën përgjegjësi për realizimin e objektivave të mobilizimit të qytetarëve për pjesëmarrjen në Protestën e 16 Marsit. Grupet e Monitorimit janë përgjegjëse për të mbledhur informacion mbi mënyrën e organizimit të punës nga degët për protestën e 16 Marsit. Ato informojnë në mënyrë të përditshme, Koordinatorin e Grupit, lidhur me informacionet që marrin. Për çdo problematikë të hasur nga sot e deri në përfundimin e protestës, Koordinatorët e Grupit informojnë menjëherë Sekretarin e Përgjithshëm dhe Kryetarin e PDSH, dhe marrin kontakt me Kryetarët e Degëve për të zgjidhur problematikën e konstatuar apo për t'i nxitur në angazhimin e Degës për mobilizimin e protestës". Sfidat e opozitës është pikërisht numri i pjesëmarrësve çka do të tregojë dhe pushtetin ndaj kryeministrit Edi Rama. Burimet kanë bërë të ditur se për këtë qëllim për herë të parë në selinë blu,



### STRUKURA

Struktura e posaçme ngarkohet me "përgjegjësi" për të mbledhur informacion mbi mënyrën e organizimit të punës në degë. Për këtë qëllim do të jenë nën monitorim listat që do të paraqesin paraprakisht degët për pjesëmarrësit dhe personat e angazhuar për datën 16 mars.

## PD, Shehu: Pa u zgjidhur ngërçi s'mund të hyjmë në zgjedhje lokale

Ish-deputeti i PD-së, Tri tan Shehu i ftuar dje në Neës 24 komentoi situatën aktuale politike. Sipas tij vendimi i PD-së për të dëgjur mandatet ishte mëse i detyrueshëm, në kushtet kur qeveria e kishte bërë të padëgjueshëm zërin e tyre. Shehu shprehet se përveç protestave opozita duhet të punojë shumë e bindë faktorin ndërkombëtar për drejtimin që ka marrë. "Djedia e mandatave ishte një vendim i detyruar, i vështirë për tu marrë por i detyrueshëm. Njëzitat janë sensibilizuar me ne, kanë dalë në protesta dhe do vazhdojnë të protestojnë sërish më 16 mars. Me ndërkombëtarët duket të sillemi me miqësi e dashamirësi, t'i bëjmë të kuptojnë se do të jetë një



lëvizje popullore masive në të mirë të shqiptarëve". - tha Shehu. Sa për zgjedhjet lokale, Shehu u shpreh se opozita nuk e ka marrë ende një vendim përfundimtar, por ai vetë mendon se në këto kushte nuk duhet të hyhet në zgjedhje. "Akoma nuk është marrë një

vendim zyrtar, unë po jap mendimin tim personal. Në kemi një ngërç politik për të zgjidhur, padyshim opozita nuk mund të marrë pjesë në zgjedhje. Ne problemim nuk e kemi tek bashkia, por tek qeveria", - tha ish deputeti I PD-së.

ngrihet një organizim i tillë, i cili përbehet nga tre të deleguar, të cilën do të monitorojnë punën e strukturave në 4 rajone në vend. Detyra kryesore bëhet e ditur se është të ndihmojë degët për realizimin e objektivave të mobilizimit qytetarëve për pjesëmarrje masive në protestë. Struktura e posaçme

ngarkohet me "përgjegjësi" për të mbledhur informacion mbi mënyrën e organizimit të punës në degë. Për këtë qëllim do të jenë nën monitorim listat që do të paraqesin paraprakisht degët për pjesëmarrësit dhe personat e angazhuar për datën 16 mars. Puna e grupeve do të vazhdojë dhe ditën e

protestës kur do të verifikojnë pjesëmarrësit në vendet e parashikuara për tu grumbulluar. Në datë 16 mars opozita do të zhvillojë protestën e radhës që sipas kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Basha do i japë goditjen përfundimtare Edi Ramës. Protesta do të zhvillohet para Kryeministrit në



Një nga protestat e PD-së

### BESNIK MUSTAJ

"Protesta është e domosdoshme dhe pjesëmarrja e njerëzve, por nuk është e mjaftueshme. Protesta duhet të shoqërohet me veprime të tjera politike të cilat nuk po i shohim. Unë besoj se tani ka një konsolidim të protestës. Tashmë Basha dhe ekipi i opozitës duhet të ofrojë një platformë të gjerë ku nuk përjashtohet dialogu me qeverinë", tha Mustafaj në News 24.

## Protesta e 16 marsit, zbardhet udhëzimi i Bashës

Një udhëzim me 6 pika i Partisë Demokratike për protestën e 16 marsit u është dërguar drejtuesve të kësaj partie në rrethe. Më këtë udhëzim, Basha mandaton kryetarët e degëve në rrethe me përgjegjësinë e organizimit të njerëzve në protestën e 16 marsit që do të zhvillohet në Tiranë. Në një prej këtyre pikave kërkohet parashikimi i pjesëmarrjes në nivel grupseksioni dhe në nivel Dege, si dhe të merren masa për evidencimin e pjesëmarrjes me qëllim vlerësimin e kontributeve, duke u kërkuar që të raportojnë më 10 dhe 14 mars. Lideri i PD-së kërkoi nga kryetarët e degëve që të shkojnë derë më derë për të mbledhur sa më shumë njerëz për ti sjellë në Tiranë. "Për të përcjellë mesazhin te qytetarët për sigurimin e pjesëmarrjes maksimale me të gjitha format, takime me strukturat, takime me qytetarët derë më derë, ture të kryetarit, fletushka, njoftime në rrjetet sociale, njoftimit me sms apo telefonata", - thuhet në udhëzim. Një tjetër pikë është edhe ajo e shpenzimeve të udhëtimit. Në udhëzim specifikohet që të paguhet udhëtimi dhe shpenzimet për protestuesit, që do të marrin pjesë në tubim.



orën 11:00, ndërsa opozita ka nisur përgatitjet për të mbledhur sa më shumë njerëz. Lideri i PD-së kërkoi nga kryetarët e degëve që të shkojnë derë më derë për të mbledhur sa më shumë njerëz për ti sjellë në Tiranë. Protesta e 16 marsit do të jetë e pesta e opozitës në një hark të shkurtër kohor. Protesta e parë e opozitës ishte në 16 shkurt përpara Kryeministrit ku u shënuan shumë incidente, ndërsa u pasua me tre të tjera para parlamentit. E ndërsa dogji mandatet dhe doli nga parlamenti, protesta e pestë e opozitës sipas Bashës do të jetë uragani që do i japë goditjen përfundimtare Ramës.



Presidenti i PPE, Daul: Ka shumë punë për të bërë që zgjedhjet të jenë të lira

# BE: Rrezikohet integrimi, qeveria të dialogojë me opozitën

Soreca: Partitë të marrin pjesë në zgjedhjet vendore

Valentina Madani

Opozita ka vendosur të mos kthehet në parlament por Bashkimi Evropian i kërkon mazhorancës dhe pakicës të gjejnë format e dialogut në mënyrë që mos rrezikohet integrimi i vendit në Evropë. Por kjo situatë politike e paprecedentë sipas Ambasadorit të BE-së, Luigi Soreca, minon procesin integruar të Shqipërisë. Ndaj Soreca apelon palët politike të gjejnë zgjidhje për atë që është edhe intesasi i 93 % të shqiptarëve. Të paprecedentë e cilëson djegien e mandateve të deputetëve nga opozita, teksa shprehet se ky qëndrim rrezikon vendimin e Qershorit për hapjen e negociatave. "Është e qartë që opozita po mban një qëndrim të saj, pamundësinë për t'u kthyer mbrapsht. Na vjen keq për këtë. Ne ua kemi thënë këtë krerëve të opozitës, por ajo që kemi kuptuar është se ata nuk kanë synim të kthehen në Kuvend. Kjo ndikon në procesin e Shqipërisë drejt BE. Ne kemi bërë thirrje për dialog, ne nuk mbajmë anë. Ne i kemi kërkuar qeverisë që të ndërmarrë çfarëdo lloj hapi që të ketë një frymë konstruktive me opozitën", tha z.Soreca. Të pafalshme e cilëson nxitjen e dhunës në protesta dhe apelon për tubime paqësore, teksa një mesazh ka për klasën politike të cilës i kujton se vetëm pak muaj i ndajnë nga gare elektorale. "I bëjmë thirrje të gjitha palëve të marrin pjesë në zgjedhjet vendore si e vetmja mënyrë demokratike", - deklaroi ambasadori i BE-së në Tiranë. Nga Vau i Dejës, bashki e drejtuar nga demokratët, përfaqësuesi i BE pati një mesazh të qartë edhe për zgjedhjet vendore të 30 qershorit. "Ftoj institucionet që të luajnë rolin e tyre në demokraci dhe të kujdesen për intesat e banorëve. I bëjmë thirrje të gjitha palëve të përgatiten për zgjedhjet vendore, sepse në fund të fundit këtë bëjnë institucionet demokratike, kujdesen për interesat e banorëve dhe qytetarëve", u shpreh ambasadori i BE. Në krah të Ambasadorit të BE, në ditën e 8 marsit u shfaq edhe deputetja demokrate Rudina Hajdari, e cila ende



Ambasadori i BE-së, Luigi Soreca

LUIGI SORECA

"Ne kemi kërkuar dialog dhe jemi të paanshëm. I kemi kërkuar qeverisë që të ndërmarrë çfarëdo lloj hapi që të ketë një frymë konstruktive me opozitën. Në rast moszgjidhje të këtij ngërçi, integrimi i Shqipërisë është në rrezik", tha z.Soreca.

**RUDINA HAJDARI PËRKRAH AMBASADORIT TË BE**

Në krah të Ambasadorit të BE, në ditën e 8 marsit u shfaq edhe deputetja e PD Rudina Hajdari, e cila ende nuk e ka thënë fjalën e fundit për mandatin. Por për mediat ajo zgjodhi të flasë si qytetare e jo si politikanë. Ajo ka paralajmëruar se vendimin për mandatin do ta marrë pas konsultimeve me ndërkombëtarët. "Uroj gratë dhe vajzat sot, të ndihen se ato mund të bëjnë ëndrrat e tyre realitet dhe mund të jenë ato gra që ndryshojnë vizionin e Shqipërisë dhe e çojnë Shqipërinë në BE sa më shpejt. Fola si qytetare e Shqipërisë", - tha z.Hajdari.



**PS, Kodheli: Djegia e mandateve fut në ngërç jetën parlamentare**

Pavarësisht përpjekjeve të mazhorancës për ta kon sideruar djegien e mandateve nga ana e opozitës si një lëvizje që nuk do ketë asnjë ndikim në funksionimin e institucionit të Kuvendit dhe të qeverisjes së vendit, duket se ky hap ekstrem i deputetëve opozitarë ka krijuar një ngërç që po ndihet dita - ditës në jetën politike dhe atë institucionale parlamentare. Këtë e pranoi edhe kryetarja e Komisionit të Jashtëm, Mimi Kodheli, e cila duke folur dje pas takimit me deputetin e parlamentit të Bavarisë, Tobias Gottard, theksoi se largimi i opozitës ka krijuar ngërç në funksionimin e Kuvendit. "Më vjen keq që kolegët opozitarë nuk kanë mundur të jenë në një takim si ky, për aq kohë sa veprimi i tyre ekstrem i pak ditëve më parë e vë në ngërç jetën tonë parlamentare", - tha Kodheli. Ndaj ajo u shpreh se mazhoranca është tashmë e gatshme të dialogojë me opozitën për t'i kthyer parlamentit normalitetin dhe për ta ndihmuar vendin të marrë statusin e vendit kandidat në qershor. "Bashkë mund t'ia dalim. Kur them bashkë mund t'ia dalim, kam parasysh: Shqipëria e mbështetur nga një vend si Gjermania, Shqipëria e mbështetur nga vendet evropiane, por Shqipëria e mbështetur edhe nga politika e saj e brendshme. Shqipëria e mbështetur edhe nga dialogu, në të cilin kërkojmë ta hapim sot me opozitën. Gjithsesi jemi aty të gatshëm për të vazhduar t'i zgjasim dorën opozitës dhe për t'i thënë "po" dialogut, pa ndërprerë aspak dhe në asnjë rast hapat tona drejt reformës dhe drejt integritimit", - tha Kodheli.

**Gottardt: Vështirësitë kapërcehen përmes bashkëpunimit**

**Deputeti gjerman në Tiranë: Ata që duan demokracinë janë pro dialogut**

Deputeti i Bundestagut gjerman, Tobias Gottardt takoi dje anëtarët e Komisionit të Jashtëm në kuadër të forcimit të marrëdhënieve shqiptaro-gjermane. Në një prononcim për mediat, deputeti gjerman tha se: "Ata që duan demokracinë janë pro dialogut". Duke folur për situatën aktuale në Shqipëri dhe vendimin e opozitës për të djegur mandateve, Gottardt theksoi se: "Doja ta prekja nga afër realitetin. Kam dëgjuar kategori të ndryshme përfaqësues fondacionesh dhe kryetarë grupesh parlamentare. Fola për reformën në



drejtë dhe implementimin e vettingut hapat që janë marrë nga Shqipëria janë të dukshme Shqipëria ka bërë përparim. Sigurisht nuk besoj që më takon mua të jap komente për situatën e

brendshëm politike dua të shpreh qëndrimin tim se ata që e duan demokracinë janë pro dialogut dhe përballimit të dyo situatë me dhënien e argumenteve gjithnjë pro dialogut. Si një evropian i bindur në vlerat që transmeton BE unë jam këtu për të mbështetur çdo hap që Shqipëria po ndërmerr drejt anëtarësimit në BE. Kjo situatë është me fitore për të dyja anët si për Shqipërinë dhe BE. Pavarësisht vendit nga i cili vijmë, mesazhi i përbashkët është: Të gjitha vështirësitë dhe risqet që na shfaqen duhet të bashkëpunojmë bashkë", tha z.Tobias Gottardt.

nuk e ka thënë fjalën e fundit për mandatin. Por për mediat ajo zgjodhi të flasë si qytetare e jo si politikanë. Vajza e liderit të Dhjetorit, Azem Hajdari, ka paralajmëruar se vendimin për mandatin do ta marrë pas konsultimeve me ndërkombëtarët. **ZGJEDHJET** Presidenti i PPE, Joseph Daul i kujton qeverisë shqiptare se ka shumë punë për të bërë që zgjedhjet të jenë të lira e të ndershme. Z.Daul duke u ndalur në problematikat e rajonit, theksoi se "ka shumë punë për të bërë që ato të jenë më të vërtetë të lira, të ndershme dhe transparente".

Mesazhin Daul e dja pas takimit me një delegacion të udhëheqësve të rinisë të partive anëtarë në PPE, në Ballkanin Perëndimor, për të folur për aktualitetin në rajon dhe për perspektivat e rinisë për situatën politike. "Rinia pëson e para nga korrupsioni sistematik dhe mungesa e pavarësisë së gjyqësorit dhe shtetit ligjor, zhvillime që bllokojnë përparimin e suksesshëm të vendeve të tyre dhe e detyrojnë rininë t'i braktisin këto vende duke u drejtuar emigracionit. Por rinia është gjithashtu dhe një nga grupimet me të rëndësishme të alternativës së nevojshme: ne kemi

nevojë për gatishmërinë, bashkëpunimin dhe dedikimin e tyre të plotë drejt paqimit në rajon, nëse ne dëshirojmë që vendet e Ballkanit Perëndimor të vazhdojnë rrugëtimin e tyre demokratik dhe Evropian. Ne duhet të rivendosim besimin që ato kanë humbur tek institucionet demokratike në vendet e tyre dhe për përfaqësimin e tyre dhe interesit të tyre nga udhëheqësit e zgjedhur Mbi të gjitha, çka ka të bëjë me gjithë rajonin, sa i përket zgjedhjeve, ka shumë punë për të bërë që ato të jenë më të vërtetë të lira, të ndershme dhe transparente", deklaroi Presidenti i PPE.

## ZGJEDHJET VENDORET

Përveç Subashit në Fier janë konfirmuar edhe Veliaj, Filo, Leli, Ndreu dhe Llatja

# Rama konfirmon Subashin në Fier: Do bëjmë më shumë në mandatin e dytë

## Takimi në kuadër të Programit të 100 fshatrave

Armando Subashi do përfaqësojë sërish Partinë Socialiste në zgjedhjet e ardhshme vendore për kryetar të Bashkisë së Fierit. Konfirmimi ka ardhur nga kryetari i Partisë Socialiste, njëkohësisht kryeministri, Edi Rama, teksa ka zhvilluar dje një takim në Libofshë të Fierit në kuadër të "Programit Kombëtar të 100 fshatrave". Ndërsa ka folur lidhur me zhvillimin agroturizmit të zonës së Libofshës, kreu i qeverisë ka theksuar se disa prej projekteve do të zbatohen gjatë mandatit të dytë të kryebashkiakut aktual të Fierit, Armando Subashi. "Si pak zona të tjera rurale në Shqipëri, Libofsha është e pozicionuar idealisht për këtë lloj zhvillimi rural të turizmit. Nuk po zgjatim me ato detaje që u sollën këtu, qoftë nga ministria, qoftë nga kryetari i bashkisë. Patjetër që edhe ajo çka u tha këtu nga kryetari i bashkisë si nevojë strategjike e zhvillimit të zonës që është dalja në det, është në vëmendjen tonë dhe do të jetë një nga projektet që ne do zhvillojmë së bashku gjatë mandatit të dytë të kryetarit të bashkisë", - tha kryeministri Edi Rama gjatë fjalës së tij në këtë takim. Në fakt ky nuk është rasti i parë ku ai ka konfirmuar ose ka prezantuar kandidatët për kryetar, por zgjedhjet e ardhshme vendore. Ai ka ndërmarrë një tur takimesh në bazë të titulluar "Bashkia që duam", ku ndërmjet të tjerave ka konfirmuar disa nga kryetarët aktualë dhe në disa bashki të tjera ka bërë edhe prezantimet paraprake të kandidatëve të rinj socialistë. Kështu, thaujse në të njëjtën mënyrë si me Armando Subashin në Fier, Rama veprimi edhe me Sotiraq Filon në Korçë, të cilin e rikonfirmoi si kryebashkiak edhe për një mandat tjetër. "Këtë do ta mbajmë në punë këtu. Ky të rrijë në punë dhe t'i marrë shënim këto vërejtje, por na duhet dhe për ca kohë", - tha Rama duke lënë të qartë tashmë se nuk ka më dilemë në drejtim të rikandidimit të tij. Të njëjtën gjë bëri ai pak javë më parë, edhe gjatë një takimi në Qytetin Studenti, në Tiranë ku la të kuptohet qartë se kandidati i PS-së për bashkinë më të madhe në vend, do jetë Erion Veliaj. "Do të fillojmë ndërtimin e këtij kampusi dhe brenda mandatit tjetër të kryetarit të bashkisë ne do të përfundojmë kampusin universitar", - u shpreh Rama gjatë atij takimi.



Kryeministri Edi Rama dje në Libofshë të Fierit

Ndërkohë që edhe pak ditë më parë, gjatë takimit me dher të mblytura të Asamblesë së Zgjeruar të PS-së së Tiranës, ai konfirmoi se PS nuk ka kandidat tjetër veç Veliajt për të konkurruar në këto zgjedhje për Bashkinë e Tiranës. Ndërsa në 16 shkurtin e shkuar, teksa

opozita protestonte para kryeministrit, Rama nga Vlora do të rikontfirmonte për një mandat të dytë edhe Dritan Lelin. "Ne me Dritan Lelin kemi bërë më shumë se në të gjitha vitet e demokracisë, unë ju siguroj që në katër vitet që vijnë do të bëjmë më shumë se në

katër vitet që po përfundojnë", - tha Rama gjatë atij takimi. Këta janë në fakt disa nga kryebashkiakët që janë rikontfirmuar për të qenë sërish kandidat në zgjedhjet e ardhshme vendore, pasi ka pasur edhe raste të tjera, ku Rama ka prezantuar edhe kandidatët

të rinj. I tillë është rasti për Bashkinë e Lezhës, ku ai la të kuptohet se kandidati i PS-së do jetë Pjerin Ndreu. Gjatë një takimi në Lezhë propozimit të një prej të pranishmëve për të kandiduar Ndreun ai iu përgjigj: "Nuk kemi ardhur këtu për të zgjedhur kandidatët. Edhe unë me ty jam, por duhet ta lëmë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve". Një tjetër kandidatëru thaujse e sigurt tashmë është ajo e Gledian Llatjas në Elbasan, i cili do zëvendësojë Qazim Sejdimin, i cili ka vendosur që të mos rikandidojë për një mandat të katërt. Ndër emrat e tjerë që përfliten në PS është edhe kandidimi i Senida Mesit në Shkodër, Flamur Golemit në Gjirokastrë, Safet Gjicit në Kukës, Ervin Demas në Berat, Tonin Marinajt në Malësinë e Madhe dhe Kastriot Gurrës në Librazhd.

### KANDIDATËT E PS

Tiranë - Erjon Veliaj  
Elbasan - Gledian Llatja  
Korçë - Sotiraq Filo  
Fier - Armando Subashi  
Vlorë - Dritan Leli  
Lezhë - Pjerin Ndreu  
Malësi e Madhe - Tonin Marinaj  
Kukës - Safet Gjici  
Librazhd - Kastriot Gurra  
Berat - Ervin Demo  
Himarë - Jorgo Goro  
Durrës - Adrian Çela?  
Shkodër - Senida Mesi?  
Gjirokastrë - Flamur Golemi?

## Rama festë me gratë: Afrohuni për vallëzim, jo për të më shqyer mua

Ndërsa gra e burra, mbështetës të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim kishin dalë në rrugë për të protestuar kundër tij në Fier, kryeministri Edi Rama zgjodhi pikërisht gratë fterake për të festuar bashkë me të 8 Marsin, Ditën Ndërkombëtare të Gruas. Dhe dilemën nëse në këtë ditë festohet apo protestohet kryeministrit duket se ia kishte zgjidhur kryetari i Kuvendit, që është dhe deputeti i qarkut të Fierit, Gramoz Ruçi. "Kemi pas një debat në qeveri për 8 Marsin, a është festë apo protestë? A duhet ta festojmë 8 Marsin dhe të lemë gratë të festojnë. Këtë dilemë e zgjidhi



Gramozit që tha hajde shkojmë në Fier se aty gratë janë edhe për festë edhe për protestë", - tha Rama në fjalën e tij para grave fterake që kishin mbushur sallën. Në këtë ditë të shënuar për gratë, ai theksoi se qeveria socialiste ka arritur pozitive sa i përket respektimit të tyre, pasi qeveria që ai drejton ka gjysmën e anëtarëve gra. "Jam krenar që ne sot i kemi dhënë këtij vendi një qeveri që zë një vend nderi në Europë pasi ka 50 % gra në kabinetin qeveritar. Dua tju them se u jam mirënjoh-

ës të gjitha grave dhe vazave në qeverinë tonë dhe në sektorin privat", - u shpreh Rama. Më pas ai ka ftuar vajzat dhe gratë pjesëmarrëse në takim që të kërcenin bashkë me të. "Për të mos e zgatur me fjalë, unë mendoj që të gjitha ju duhet të vini këtu, në arenë. Gjej një muzikë për vallëzim, por jo ai vallëzimi grua me grua, por për festë dhe protestë. Afrohuni tani, afrohuni, për vallëzim, jo për të më shqyer mua, por për vallëzim", - tha Rama.

## Djegia e mandateve, Kume: Ekziston një shteg që mund të kthehen

Ndërsa opozita i ka dorëzuar mandatet e deputetëve të saj, ekspertët thonë se ekziston ende një "derë" që mund t'i rikthejë ata sërish në parlament. Sipas ish kreut të KQZ-së, Kristaq Kume, procedura për lënien e mandateve nuk është ndjekur në mënyrë të rregullt, ndaj nëpërmjet këtij shtegu, ish-deputetët, nëse arrihet një marrëveshje politike, edhe mund të rikthehen sërish në Parlament. "Ka shteg që mund të kthehen, të gjithë ata që ikën mund të kthehen në Kuvend. Nuk është zbatuar procedura ligjore për dorëheqjen nga mandati. Deputetët, ose

ata që ishin deputetë, deklaruan dorëheqjen vetëm me shkrim, që u depozitua në Kuvendin e Shqipërisë. Ligji zgjedhor thotë: Nuk nje, nuk përbën shkak për ndërprerjen e mandatit neni 164, deklarata kolektive ose publike. Që të mund të ndërpritet mandati, duhet që deputeti të deklarohet publikisht përpara Këshillit të Mandateve që dorëheqet nga cilësia e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë. Kjo gjë nuk është bërë, nuk është mbledhur Këshilli i Mandateve, nuk ka administruar Këshilli i Mandateve kërkesat, ose dorëheqjet e deputetëve", - deklaroi Kristaq Kume, ish-kryetar i KQZ-së.



### SHPLLJE ANKANDI

Zyra Permbarrimore "E.G. Balliff Service" me përmbarrues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 05.04.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandit i II-të për shpëtim e pasurisë së paluajtshme, me numër pasurie Nr 5/264/ND+1-2, ZK 8250, me sipërfaqe 137 m<sup>2</sup> me adresë Tiranë, në pronësi Z. Bujar Musa Kajtazi me vlerë fillestare në ankand 69,216 (Gjashëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit +355 4 22 31 888.

Një vit më parë ish-kreu i akuzës u shpall i padëshiruar për korrupsion

# Ish-kryeprokurori Adriatik Llalla punëson lobistë në SHBA: Më hiqni nga "lista e zezë"

## Kërkesa është depozituar pranë DASH-it më 15 shkurt nëpërmjet studios "Sher termonte"



SHBA

Ish-Prokurori i Përgjithshëm, Adriatik Llalla - asetat e të cilit janë nën sekuestro pasi është nën hetim për pastrim parash, ka punësuar dy lobistë nga Nju Jorku për të kundërshtuar vendimin e Departamentit të Shtetit që e shpalli "persona non-grata" në SHBA.

Michael Gibaldi është një jurist i diplomuar 'summa cum laude' nga Universiteti Pensilvanisë dhe i Harvardit dhe specializohet me fokus në çështje penale, administrative si dhe gjyqet tregtare komplekse. Shefi i tij, Michael Tremonte është ish-prokuror dhe avokat me eksperiencë - partner dhe themelues i studios ligjore 'Sher Tremonte LLP'.

Me zyra në 'Broad Street' të Manhattanit - zemra e distriktit financiar të Nju Jorkut, Sher Tremonte LLP është një studio ligjore e specializuar në përfaqësimin e kompanive në konflikte tregtare komplekse si dhe probleme ligjore që lidhen me të ashtuquajturit 'jaka të bardha'.

Në datën 4 mars, studioja ligjore Sher Tremonte - e përfaqësuar nga dy juristët Gibaldi dhe Tremonte është regjistruar në Dhomën e Përfaqësuesve të Kongresit të SHBA si kompani lobimi për ish-Prokurorin e Përgjithshëm të Shqipërisë, Adriatik Llalla.

Sipas formularit të regjistrimit, një kopje e të cilit është siguruar nga BIRN, qëllimi i aktiviteteve të lobimit, të ndërmarrja nga "Sher Tremonte" në emër të ish-prokurorit shqiptar në SHBA lidhet me vendimin e Departamentit të Shtetit për ta shpallur Llallën dhe familjen e tij si persona non-grata. "Shfuqizimi i vendimit të Departamentit të Shtetit i datës 14 shkurt 2018, për të listuar Adriatik Llallën dhe familjen e tij të afërt si të papërshtatshëm për hyrje në Shtetet e Bashkuara," përkthuhet si qëllimi i aktiviteteve të lobimit në formular. Llalla u shpall i padëshiruar nga Departamenti i Shtetit një vit më parë, me motivacionin e përfshirjes domethënëse në korrupsion. Përveç Llallës, në formular listohet si financues i aktiviteteve të lobimit në një vlerë më të madhe se 5 mijë USD edhe një kompani nga Nju Xhersi, e quajtur 'Lita Brothers Construction' - në pronësi të familjarëve të nënkryetarit të bashkisë së Kamzës, Korab Lita. Shuma totale që ka paguar Llalla dhe kompania "Lita Brothers Construction" për aktivitetet e lobimit mbetet e paqartë.

I kontaktuar nga BIRN nëpërmjet telefonit, Llalla nuk ju përgjigj një kërkesë për koment. Edhe lobistët



Adriatik Llalla

Gibaldi dhe Tremonte gjithashtu nuk iu përgjigjën një kërkesë të BIRN për koment nëpërmjet emailit.

Ndërkohë, nënkryetari i bashkisë së Kamzës, Korab Lita i tha BIRN se nuk kishte lidhje me përpjekjet e Llallës për lobim në SHBA.

"Unë jetoj në Shqipëri dhe nuk kam asnjë lidhje fare," u shpreh Lita prerazi.

### NON-GRATA NË SHBA

Adriatik Llalla u zgjodh Prokuror i Përgjithshëm në vitin 2012 dhe e mbajti këtë post deri në nëntor 2017, kur i mbaroi mandati 5-vjeçar dhe u zëvendësua nga Prokurorja e Përgjithshme e Përkohshme, Arta Marku.

Gjatë mandatit të tij në krye të Prokurorisë së Përgjithshme, Llalla u përball me akuzë për punë të dobët në luftën kundër krimit dhe korrupsionit, ndërkohë që pati edhe një përplasje publike me ish-ambasadorin e SHBA-ve në Tiranë, Donald Lu, me të cilin e ndanin pikëpamjet për reformën në drejtësi.

Nëpërmjet një njoftimi publik një vit më parë, në mesin e muajit shkurt, ish Sekretari amerikan i Shtetit, Rex Tillerson shpalli vendimin për ta vendosur Adriatik Llallën në një listë të zezë zyrtarësh që i ndalohej hyrja në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, së bashku me familjen.

Ligji amerikan parashikon që në rastet kur ka informacione të besueshme se zyrtarë të huaj përfshihen në raste mëdha të korrupsionit, ose në shkelje të rëndësishme të drejtave të njeriut,

këtyre individëve dhe familjes së tyre të afërt u ndalohej hyrja në Shtetet e Bashkuara.

Sekretari i Shtetit ka të drejtë që sanksionet ndaj këtyre individëve dhe familjeve të tyre, t'i miratojë privatisht ose t'i bëjë publike, siç ishte rasti i z. Llalla. Përveç Llallës, vendimi sanksionon hyrjen në Amerikë edhe për bashkëshorten e tij, Ardiana Llalla, të vajzës Eni Llalla dhe të një fëmije tjetër që nuk ka shtetësi amerikane. Por duket se ish-prokurori nuk është pajtuar me vendimin e marrë nga Departamenti amerikan i Shtetit dhe për ta përmbysur atë, ka punësuar studio ligjore "Sher Tremonte" LLP. Studioja ligjore Sher Tremonte LLP nuk është një kompani klasike lobimi. Megjithatë, në kongresin amerikan, avokatët Gibaldi dhe Tremonte njihen si dy juristët që kanë asistuar gjatë intervistës përpara Senatit lobistin ruso-amerikan, Rinat Akhmetshin.

Sipas mediave amerikane, Akhmetshin ka qenë një agent sovjetik i kundërbullimit dhe është lidhur me një fushatë lobimi në SHBA për të shfuqizuar të ashtuquajturin ligji "Magnitsky". Ky ligji i miratuar nga Kongresi Amerikan në vitin 2012, ka për qëllim sanksionimi e personave të lidhur me vdekjen në një burg të Moskës, të kontablistit rus Sergei Magnitsky.

Midis Llallës dhe Akhmetshin nuk duket se ka ndonjë lidhje, përveçse të dy palët

### AKUZAT


Në kohën që Adriatik Llalla bën përpjekje nëpërmjet lobistëve në SHBA për të hequr emrin nga lista e zezë e Departamentit të Shtetit, ai po hetohet në Shqipëri nën dyshimin se është përfshirë në një skemë pastrimi parash. Akuzat ndaj Llallës përfshijn veprat penale: "Refuzim për deklaram, mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë i pasurisë, interesave private të të zgjedhurve dhe nëpunësve publikë", "Mosdeklarim të shumave monetare në kufi", "Pastrim të produkteve të veprës penale" dhe "Shpërdorim detyrë".

kanë punësuar të njëjtët avokatë për t'i asistuar me problemet e tyre ligjore në SHBA. Kompania 'Lita Brothers Construction' është regjistruar në SHBA në vitin 2005, në Cliffside Park, Nju Xhersi në emër të Bedri Litës. Aktualisht kompania e ka selinë në 378 South Eastington Avenue, Bergenfield.

Bedri është vëllai i Korab Litës, nënkryetarit të bashkisë së Kamzës. Vëllezërit e Korab Litës, emigrantë prej shumë vitesh në SHBA, janë aktivë në komunitetin shqiptar-amerikan. Përpjekjet për të kontaktuar kompaninë 'Lita Brothers Construction' nëpërmjet telefonit rezultuan të pasuksesshme, ndërkohë që lidhja e tyre me ish-prokurorin Adriatik Llalla mbetet e paqartë.

### HETIMET NDAJ LLALLËS

Në kohën që Adriatik Llalla bën përpjekje nëpërmjet lobistëve në SHBA për të hequr emrin nga lista e zezë e Departamentit të Shtetit, ai po he-



bëjnë produkt të veprës penale," deklaroi prokuroria.

Hetimi ndaj Llallës u regjistrua fillimisht nga Prokuroria e Durrësit më 15 mars 2018 nën akuzën e fshehjes së pasurisë, shpërdorimit të detyrës dhe pastrimit të parave. Një investigim i mëparshëm i BIRN tregoi se si Llalla transformoi një investim fillestar prej 16.3 milionë lekësh në pronë me vlerë mbi 1 milionë euro përmes transakcioneve me një person të dënuar për vrasje, një biznesmen -fitues tenderi në Prokurori dhe një instruktor hipizimi i përdorur si sekser tokash.

Dokumentet e siguruar nga BIRN tregojnë se Adriatik Llalla bleu katër parcela tokë me sipërfaqe totale prej 22 mijë metrash katrorë nga dhjetori i vitit 2016 deri në maj të vitit 2017. Të katër kontratat i kushtuan 14.8 milionë lekë në total ish-kryeprokurorit, me një çmim që luhet nga 600 në 1 mijë lekë për metër katror. Menjëherë pas blerjes, Llalla i përfshiu tokat në procesin e rivlerësimit dhe sipas çmimeve të referencës, vlera e tyre tokë u rrit me 6-fish, duke kapur shifrën e 93.7 milionë lekëve. Llalla e ka deklaruar veten të pafajshëm ndaj akuzave. Megjithatë, pas gati 1 vite e gjysmë pa punë dhe me asetet e tij të ngrija nga Prokuroria, mbetet e paqartë se me çfarë mjetejsh financiare e ka siguruar ai shërbimin e studios ligjore amerikane 'Sher Tremonte LLP'./

MARRE NGA BIRN

## Nesim Demollari: E gjeta të vdekur

### Vrau nënën, Gjykata lë në "Arrest me burg" 64-vjeçar

**KORÇË** - Gjykata e Shkallës së Parë në Korçë ka vendosur dje masën e sigurisë "Arrest me burg" për 64-vjeçarin Nesim Demollari, i akuzuar si autor i vrasjes së nënës së tij 84-vjeçare, Nazime Demollari. Ngjarje kjo e ndodhur paraditen e 4 marsit, në lagjen nr.14 të qytetit juglindor. Gjatë seancës gjyqësore, I pandehuri, Nesim Demollari nuk pranoi krimin para trupit gjykues. "Nuk janë

të sakta çfarë tha prokurori. Mamanë e gjeta në korridor. E ushqeja unë. Ajo bënte vepime të pandërgjegjshme. Më quante Goni, jo Nesim. Dilte nga shtëpia vetë. Ishte me sklerozë, binte dhe rrezohej vetë. E gjeta midis banjës dhe korridorit të shtrirë. E çova në dhomë. I shërbeja prej vitesh. Mamaja kishte rënë nga divani me kokë. Dy ditë më përpara vrau syrin. Nuk e kam vrasur unë, vdiq vetë. Pastaj vdiq mora vëllanë në telefon dhe e njoftova se kish-



te vdekur", tha Nesim Demollari. Ndërsa, u shpreh se "kam punuar 20 vite në Greqi. Jam i pafajshëm. Të gjykohej nënë". Dua të punoj, se nuk kam të ardhura". Nga ana tjetër, Prokuroria kërkoi masën arrest me burg, pasi ka prova që 64-vjeçari e ka dhunuar nënën derisa ajo humbi jetën. Në gjykatë dëshmuar edhe fqinjët e të akuzuarit, të cilët thanë se Demollari e rrahu nënën për 30 minuta.

## Akuzohet për masakrën në ish-Blok

### Gjykata e la të lirë, Prokuroria apelon vendimin për Ervin Matën

**TIRANË** - Pak ditë pasi u vëtdorëzua në polici, Gjykata e Tiranës vendosi ta lërë të lirë biznesmenin Ervin Matë, i përfshirë në masakrën e ndodhur në ish-Blok më 4 tetor të vitit që shkoj, ndërkohë që prokuroria kundërshtoi këtë vendim. Organi i akuzës ka apeluar dje vendimin e togave të zeza, duke kërkuar ndryshimin e masës së sigurisë nga "Detrim paraqitje në "Arrest me burg". Vrasja që

tronditi mbarë opinionin publik ndodhi mbrëmjen e 4 tetorit në lokalin "Metropol". Në këtë ngjarje mbeti i vrarë 23-vjeçari Fabil Gaxha, ndërsa u plagos Ervis Martinaj së bashku me Eljon Haton. Për ngjarjen vijon të qëndroj në burg biznesmeni Martinaj, i cili nga ekzaminimi i telefonit celular rezultoi se kishte organizuar njerëz të armatosur për përleshjen në blok ndër-sa Geldo Hoti, Ajaks Boshnjaku, Redi Popesku, Fabil Alushi u lanë të lirë pas ar-



restimit. I lirë u la edhe Eljo Haton, i plagosur bashkë me Martinajn. Siç është bërë e ditur, Gaxha u qëllua për vdekje nga komanda Mevlio Billo si pasojë e një përplasje me armë mes grupit të Ervis Martinajt dhe atij të Ervin Matës. Pak para se të ndodhte krimi, jashtë lokalit ka qënë edhe e fejuara e Matës, këngëtarja Elvana Gjata, por pas hetimeve policia tha se ajo s'kishte lidhje me ngjarjen.

"Akuzohem për agjitacion në bashkëpunim me gazetarin Olldashi, por s'kam frikë"

# Ervin Saliانji thirret në Prokurori për audiopërgjimin "Xhafaj-Babale"

## Ish-deputeti demokrat: Denoncova një trafikant ndërkombëtar droge, por i pandehur jam unë

**TIRANË**

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Ervin Saliانji ka mbërritur mëngjesin e djeshëm në prokurorinë e Tiranës, pasi është thirrur në cilësinë e të pandehurit në lidhje me çështjen "Xhafaj-Babale" nga dy prokurorët e çështjes, Genci Qano dhe Kol Hysenaj. Saliانji ka qëndruar rreth 30 minuta në zyrën e prokurorëve dhe në dalje e cilësoi vendimin si politik.

Ai deklaroi se është marrë i pandehur vetëm se ka denoncuar një trafikant ndërkombëtar droge, në një kohë që të tjerët persona duhet të ishin në vend të tij. Përmes ironisë, ish-deputeti demokrat Saliانji tha se akuzohet për agjitacion në bashkëpunim me gazetarin Jetmir Olldashi. Ndërsa, sapo të njihet me aktet e dosjes do t'i bëjë publike për mediat. Ai u shpreh se nuk është bërë asnjë hetim për të akuzuarit dhe se në këtë përballje me drejtësinë nuk ka frikë. "Denoncova një trafikant ndërkombëtar droge që



Ish-deputeti dmokrat Ervin Saliانji

### REAGIMI I PD

Pas marrjes i pandehur të Saliانji nga prokuroria e Tiranës, reagoi Partia Demokratike. Në reagimin e saj më 6 mars, PD deklaroi se vendimi i prokurorisë është vendimi politik i kryeministrit Rama. "Prokuroria nuk zgënjëu dhe sot, kur zyrtarizoi vendimin politik të Edi Ramës për marrjen të pandehur të Ervin Saliانji. Asnjë surprizë nuk ka në këtë vendim, ku i akuzuar është denoncuesi dhe jo ai që bën krimin. Rama e prokuroria nuk do t'ia mbyllin gojën opozitës", - thuhej ndër të tjera në reagimin e PD-së.

sot është në burg, por i proceduar jam unë. Pasi të njihemi me aktet e dosjes do i bëjmë publike. Duhet të kish-

te hetim për Ballën, Veliu dhe Xhafajën por kjo është si kronikë e kohëve të vjetra. Mund të fliste TVSH e ko-

hëve të vjetra dhe të thosh-te që elementët agjitorë arritën të fusnin në burg një socialist. Unë akuzohem për agjitacion në bashkëpunim me gazetarin Oll-dashi", - tha Ervin Saliانji. Ky vendim, vijoi Saliانji është marrë nën ndikim politik. "Prokurorët nga hallet që kanë për shkak të vettingut apo për shkak të lidhjeve të vjetra të tyre kanë arritur në këtë konkluzion. Kaq për sot, sa të njihemi me aktet e dosjes do i bëjmë publike. Ky është faulli i rëndë i një shteti që e ka marrë rrugën e rrëzimit", pohoi ai. Ervin Saliانji është marrë i pandehur, pasi rezultoi si personi që kontaktoi me Albert Veliu dhe nëpërmjet gazetarit Jetmir Olldash publikuan në shtet dhe PD-së audiopërgjimin e rremë për çështjen "Babale". Kjo vepër penale, kallëzim i rremë, sipas nenit 305 të kodit penal ka një marzh dënimi nga gjobë deri në 5 vite burg. Ish-deputeti i PD-së rrezikon dënimin me gjobë deri në 5 vite burg nga drejtësia.

## NJE FJALE

### Policia aksion antikanabis në gjithë vendin, territori rezultoi në pastër

**TIRANË** - Policia e Shtetit ka ndërmarrë një aksion në të gjithë territorin e vendit për parandalimin e kultivimit të kanabisit. Mësohet se në këtë aksion u angazhuan 289 grupe kontrolli nga Drejtoritë Vendore të Policisë dhe Drejtoritë Vendore të Kufirit e Migracionit, 1.110 punonjësit policie me 203 automjete policie dhe 2 mijte lundruese. Ndohëse u kryen gjithsej 4.922 kontrolle/rikontrolle, në sera, objekte e banesa, policia nuk gjeti asnjë rrënjë kanabis. U kontrolluan 1795 sera/minisera, 1036 magazina/objekte, 883 ish objekte ushtarake, 509 shtëpi të braktisura, 299 stane/stalla, 407 ambiente të hapura, 43 parcela të kultivuara në vitet 2016-2017. Gjithashtu, gjatë kontrolleve të ushtruara në territor dhe në ambiente të mbyllura nuk është konstatuar asnjë rast i kultivimit të bimëve narkotike.

### "Nuk ka prova", Gjykata liron 8 personat e arrestuar për protestën e 5 marsit

**TIRANË** - Gjykata e Tiranës ka vendosur të lirojë të gjithë të arrestuarit e protestës së 5 marsit, me arsyetimin e se nuk ka prova bindëse. Vendimi është dhënë, ndërsa 8 personat e arrestuar janë rikthyer në liri. Bëhet fjalë për shtetasit: Lorenc Bezat, Ervis Gasprri, Adi Mecja, Ervin Ceka, Lulzim Daci, Armando Prendi, Miklovan Ndreu dhe Nikoll Cepa. Sipas policisë këta persona gjatë tubimit, kanë kundërshtuar, goditur me mjete të forta e lëndë plasëse, gurë, shkopinj, fishëzkjarre etj, punonjësit e Rendit. Ata u arrestuan në flagrancë nga policia me akuzën për kryerjen e veprave penale: "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme", "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik", "Goditje për shkak të detyrës" dhe "Prishja e qetësisë publike".

### Ngec në rrjetën e vettingut, KPK shkarkon nga detyra prokurorin Arqile Koça

**TIRANË** - Prokurori i Prokurorisë së Përgjithshme, Arqile Koça ka ngecur në rrjetën e vettingut. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit pasi ka verifikuar figurën e tij ka vendosur ta shkarkojë nga detyra. Pas verifikimit ka rezultuar se Koça nuk justifikonte pasurinë. Arqile Koça, u nënshtrua vettingut për tri kriteret, atë të ligshmërisë së pasurisë dhe kriterin etik dhe profesional. Prej afro 1 viti Koça drejtonete në Prokurorinë e Përgjithshme zyrën e marrëdhënieve me jashtë, ndërsa konkurroi për tu bërë edhe kryeprokuror pas largimit të Adriatik Llalles.

### Mashtrim në vlerën e miliona eurove, Gjykata dënon me 10 vjet burg stomatologun Olesia Duka

**DURRËS** - Gjykata e Durrësit ka dënuar me 10 vjet heqje lirie stomatologun Olesia Duka, e cila përmes mashtrim-it u ka marrë disa miliona euro biznesmenëve në Durrës dhe Tiranë. Mësohet se Duka ka përfutur nga ulja e dënimet me 1/3, pra nga 15 vite heqje lirie u dënua me 10 vite pasi ka pranuar akuzat. Gjykata njohu edhe borxhet që stomatologu ja ka marrë biznesmenëve përmes mashtrimit. Duka u arrestua vitin e kaluar, pas denoncimit të parë të bërë në prokurori nga pronari i një zyre këmbimi valutor dhe agjencie udhëtimi. Nëpërmjet mashtrimit ajo ka mundur t'i marrë afro 900 mijë euro, ndërsa të njëjtin fat patën edhe disa biznesmenë të tjerë.

#### NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e pare për pasurinë :  
1- Truall, me sipërfaqe 250 m2 dhe sipërfaqe ndërtese 85m2, e ndodhur në Blinckë, Devoll, në Zonën Kadastrale 1202, Numri i Pasurisë: 1931/50, Vol. 23, Faqe. 70, në pronësi të Vasil Ferit Muzeku Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën 8.000 (tete mijë euro) EURO ose 1.000.000 (nje milion) LEKE.  
Ankandi i pare për pasurinë e mesiperme zhvillohet me datë 15.03.2019 , ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përbaruese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr."Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 0699381883 .

#### NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e trete për pasurinë :  
1-"Are", me sipërfaqe 1.200 m2, e ndodhur në Katundin e Ri, Tiranë në Zonën Kadastrale: 2119, Numri i Pasurisë: 97/1/1, Vol. 2, Faqe. 19761 në pronësi të Albert Seadin Duka Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën 19.152 (nëntëmbëdhjet mijë e njëqind e pesëdhjet e dy) EURO ose 2.394.000 (dy milion e treqind e nëntëdhjet e e kater mijë ) LEKE.  
Ankandi i trete për pasurinë e mesiperme zhvillohet me datë 01.04.2019 , ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përbaruese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr."Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 0699381883 .

Si bëhet bashkimi familjar kur fëmija ka lindur në shtetin helen, dokumentat

# Emigrantët e larguar nga Greqia, procedura për të marrë sërish leje qëndrimi

## Shembujt konkretë dhe tarifatat që duhet të paguani

Voltiza Duro

Të gjithë emigrantët shqiptarë në Greqi që më parë dispononin një leje qëndrimi 10 vjeçare, por që janë larguar nga shteti helen për jo më shumë se dy vjet, tashmë mund të rinovojnë dokumentat. Gazeta Shqiptare zbardh sot udhëzimet e Ministrisë së Emigracionit në Greqi, ku sqarohen me shembuj konkretë se çfarë procedure ndiqet për një sërë kategorish që kishin pasur ose jo leje qëndrimi dhe duan ta marrin atë tani. Pavarësisht se këta emigrantë janë larguar nga shteti grek, sërish mund të përfitojnë leje qëndrimi. "Gjatë viteve që kanë qëndruar në Greqi në mënyrë ilegale, çdo dokument që vërteton banimin në shtetin grek do të luajë rol të rëndësishëm për të vërtetuar qëndrimin e emigrantit në shtetin fqinj. Në rast se janë familjarë dhe nuk kanë për çdo vit dokumenta që vërteton banimin e emigrantit, janë të mjaftueshme vërtetimet nga shkolla, deklaratat tatimore (forologjiki dilosi), nëse kanë siguracion, etj", theksohet në udhëzimin.

### SHEMBUJ KONKRETË

Një emigrant shqiptar ka qenë i pajisur me leje qëndrimi nga viti 2010 deri 2015 në shtetin grek. Aplikimi për lejen e qëndrimit që bëri me datë 30.03.2015 iu refuzua sepse nuk kishte numër të mjaftueshëm ensimash (sigurime shoqërore). Pavarësisht kësaj, atij i lind e drejta të riaplikojë nëse nuk është larguar nga shteti grek. Një tjetër rast, është ai i një emigrant shqiptar i pajisur me leje qëndrimi në periudhën 2005-2010. Shtetasi i sipërpërmendur, u largua nga shteti grek në periudhën 2012-2014 dhe më pas u rikthye sërish, me pasaportë 3 muore dhe vazhdon të jetojë në Greqi deri më sot. Në këtë rast, ka të drejtë të aplikojë sërish për leje qëndrimi nëse nuk është larguar më nga Greqia që në momentin që erdhi me pasaportë. "Një emigrant ka qenë i pajisur me leje qëndrimi në periudhën 2006-2011. U largua për dy vjet nga Greqia në 2012-2014 dhe më pas erdhi sërish me pasaportë 3 muore dhe vazhdon të jetojë në Greqi deri sot. Në këtë rast ka të drejtë të aplikojë për leje qëndrimi, sepse dy vitet e fundit (2015 dhe 2016)



Foto ilustruese

### VËRTETIMET

"Gjatë viteve që kanë qëndruar në Greqi në mënyrë ilegale, çdo dokument që vërteton banimin në shtetin grek do të luajë rol të rëndësishëm për të vërtetuar qëndrimin e emigrantit në shtetin fqinj. Në rast se janë familjarë dhe nuk kanë për çdo vit dokumenta që vërteton banimin e emigrantit, janë të mjaftueshme vërtetimet nga shkolla, deklaratat tatimore (forologjiki dilosi), nëse kanë siguracion, etj", theksohet në udhëzimin.

vazhdon të jetojë në Greqi", bën me dije një prej zyrarëve të avokatit që mbulon çështjet e emigracionit në Greqi.

### BASHKIMI FAMILJAR

Në rast se njëri nga prindërit, në momentin e lindjes së fëmijës është i pajisur me leje qëndrimi, atëherë ka të drejtë të bëjë bashkimin familjar dhe të pajisë edhe bashkëshortin/en me leje qëndrimi. Dy kushtet kryesore që duhet të plotësohen janë: dokumente që vërtetojnë se prindërit jetojnë në shtetin grek pas lindjes së fëmijës; si dhe në

momentin e fillimit të procedurave për bashkim familjar; shtetasi duhet të jetë i pranishëm në shtetin helen. Ndërkohë, prindi që aplikon për leje qëndrimi nuk duhet të ketë munguar nga Greqia më shumë se 6 muaj në dy vitet e fundit. Kjo mund të vërtetohet me librezën e vaksinimit të fëmijës, me vërtetimet nga shkolla, nga kurset (frontistirio) që ndoshta ka bërë fëmija, si dhe nga aktivitetet që fëmija ka marrë pjesë. "Në rast se do të filloni aplikimin sërish dhe do të pajiseni me leje qëndrimi,

### BASHKIMI FAMILJAR

Në rast se njëri nga prindërit, në momentin e lindjes së fëmijës është i pajisur me leje qëndrimi, atëherë ka të drejtë të bëjë bashkimin familjar dhe të pajisë edhe bashkëshortin/en me leje qëndrimi.

atëherë paravolo (tarifa) është 150 euro. Në rast se do të filloni sërish aplikimin për leje dyvjeçare, paravolo është 300 euro", thotë Ministria e Emigracionit.

### BLERJA E SIGURIMEVE SHOQËRORE

Që nga data 1 dhjetor 2015, të gjithë emigrantët shqiptarë në Greqi, kanë të drejtë të fillojnë të blejnë ensimash (sigurimet shoqërore) që iu mungojnë për të plotësuar ditët e nevojshme dhe të fillojnë procedurën e aplikimit për lejen e qëndrimit. Madje edhe për bashkimin familjar duhet që të dy partnerët të kenë numrin e ensimave që iu nevojitet për të aplikuar për lejen e qëndrimit.

### MARRJA E NËNSHTETËSISË

I pyetur nga Gazeta Shqiptare, eksperti Fatos

Malaj, tregon se procedura për kryerjen e shkëputjes nga leja e qëndrimit, mund të kryhet automatikisht. "Në momentin që një emigrant shqiptar merr nënshkrimin grek, kjo paraqitet në gazetën qeveritare. Para funksiononte në këtë qëndrim, emigrantit duhet të shkente në Qendrën e Emigracionit ku dhe kishte marrë lejen e qëndrimit, dhe bënte shkëputjen nga kjo leje në mënyrë që të merrte nënshkrimin. Por kjo ishte një procedurë që zgjaste 2-3 javë. Tashmë procedura është lehtësuar dhe bëhet automatikisht", thotë Malaj. Megjithatë heqja e lejes së qëndrimit mund të duket një veprim i thjeshtë, në fakt njerëzve u kushtonte shumë, sidomos të rinjve të brezit të dytë që mund të kishin shans për të shfrytëzuar programe studimi jashtë shtetit, dhe nuk pajiseshin në kohën e duhur me këtë dokument grek. Kjo sepse nuk mund të paraqiteshin direkt në zyrat e shtetasve të huaj dhe emigracionit, por duhej që më parë të linin një takim e cili mund të realizohej edhe pas disa muajsh. Ndërkaq edhe mbajtësit e "kartës së homogenitetit", duhej të paraqiteshin në polici për të anuluar kartën e tyre. Pra, gjithë kjo procedurë sillte një zvarritje të panevojshme, në një kohë që gjithçka mund të zgjidhej në mënyrë elektronike nga shërbimet administrative greke.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Realizimi i lidhjes online ndërmjet godinave të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë tre vjeçare".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 9,720,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Realizimi i lidhjes online ndërmjet godinave të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë tre vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 01 Prill 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbim konsulence në fushën e redaktimit (proofreading) në gjuhën angleze për përcjelljen në publik të informacionit të BSH për vitin 2019".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Ftesë për kuotim kombëtare", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 472,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim.

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 18 Mars 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



**Dëshmi tronditëse: Jam abuzuar seksualisht në moshën 12 vjeçare**

# Festa e 8 marsit pritet me "Protestën e Zisë", gratë marshojnë kundër dhunës

**Voltiza Duro**

**N**ë ditën ndërko mbëtare të grave, dhjetëra gra e vajza, protestuan për më shumë të drejta e barazi duke sjellë në vëmendje mesazhe sensibilizuese për shoqërinë. Fillimisht, ato marshuan nga Drejtoria e Policisë në kryeqytet drejt Ministrisë së Shëndetësisë dhe madje mbajtën një minutë heshtje për të gjitha gratë e vajzat që humbën jetën si pasojë e dhunës nga bashkëshortët, të afërmit, apo të dashurit e tyre. Të organizuar në një marshim të cilësuar "Protesta e zisë" dhjetëra gra kanë kërkuar nga institucionet dhe shoqëria të mos rrinë indiferentë ndaj fenomeneve abuzuese ndaj grave të cilat shpesh në shoqërinë shqiptare cilësohen si pronë, me pa të drejtë ankimi. Protesta me pankarta në duar zgjati rreth një orë, ku gratë e vajzat i bënë thirrje instancave përgjegjëse që reagojnë e tyre të jenë më të ashpër ndaj agresorëve që dhunojnë femrat. "Nuk duam lule por të drejta" thërrisnin gratë njëzëri ndërkohë që gjatë tubimit debatuan edhe me drejtueshën e politikave në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Merita Xhafaj. Gjithashtu, gjatë protestës gratë e vajzat bënë denoncime edhe për dhunë seksuale. "Jam abuzuar në moshën 12 vjeçare. Për çfarë duhet të festoj unë sot kur autori është i lirë dhe më kërcënon me jetë? Për çfarë duhet të



Protesta e grave për 8 Marsin

festoj unë sot?! Unë kam frikë të dal në rrugë, edhe në dyqan nuk shkoj dot", - tha një protestuese.

## DEKLARATA E MINISTRES

"Me ndryshimet në ligjin për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, gratë do të marrin urdhër të menjëhershëm mbrojtje, për tu strehuar në institucionet tona të përkujdesit. Urdhër të menjëhershëm mbrojtje-

## LIGJI

"Me ndryshimet në ligjin për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, gratë do të marrin urdhër të menjëhershëm mbrojtje, për tu strehuar në institucionet tona të përkujdesit. Urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje do të marrin edhe fëmijët pavarësisht nëse ndaj tyre është ushtruar dhunë ose jo", -tha Manastirliu

je do të marrin edhe fëmijët pavarësisht nëse ndaj tyre është ushtruar dhunë ose jo", -tha ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, gjatë vizitës në Qendrën Kombëtare të Trajtimave të Viktimave të Dhunës në Familje, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas. E shoqëruar nga personazhe të njohur të ekranit dhe kinematografisë, Manastirliu bashkëbisedoi me gratë që marrin shërbime në qendër, ku vuri theksin te riintegrimi i tyre në shoqëri. "Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje shërben si një vend, ku fillon ndryshimi i jetës për secilin nga viktimat e dhunës në familje, pasi ato mbështeten me ofrimin e shërbimeve cilësore dhe me standarde, duke patur si prioritet fuqizimin e grave dhe integrimin e suksesshëm në jetën normale të viktimave të dhunës në familje" - deklaroi ministria. Gjatë vitit 2018 janë trajtuar 90 raste, nga të cilët 34 gra, së bashku me 56 fëmijë.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSTITUCIONI PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

### NJOFTIM – SHPALLJE

PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E "VAKANCËS SË PARAKOSHME" TË KRIJUAR PËR VENDIN GJYQITAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 93, 125, 127 pikat 1/c, 2, 3, dhe nenit 179 pika 2 të Kushtetutës, nënvep 7 pika 2, 7/a, 7/b, 7/dh pika 2, 86 pika 4 shkronja "c", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 9, datë 24.10.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, njoftuar nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr. 380/4 prot, datë 29.10.2018, me cilësinë e organit të emërtësës, me qëllim plotësimin e "Vakancës së parakoshme", të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, dhe me cilësinë e organit të emërtësës me Dekretin nr. 10946, datë 09.11.2018, ka miratuar;

n Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për plotësimin e "Vakancës së parakoshme" të krijuar nga përfundimi përpara kohë i mandatit të ish-gjyqtarës Znj. **Alitna Xhoxhaj**, sipas vendimit nr. 9, datë 24.10.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

#### Presidenti i Republikës fton;

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit dhe nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë të konkurimit të hapur publik, për vakancën e mësipërme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës;

- Kërkesën për shpejdhjen e interesit për të kandiduar për vendin vakant të shpallur;
- Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (*numër telefoni/email*);
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dokumentacionin shoqëruar nëpërmjet të cilit vërtetohet përbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Formulari i vetëdeklarimit, është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Formularin e aplikimit të plotësuar "Për informim përpara emërimt/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", formular ky i cili është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Listë të dokumentacionit të dorëzuar, të firmosur nga aplikanti.

Për lehtësimin e të gjithë aplikantëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, më poshtë geni të botuar përbushjen e nenit 125, pika 4 e 5 të Kushtetutës dhe nenit 7/a, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese,

#### ■ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

##### Neni 125

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

■ Ligji nr.8577, dt 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

##### Neni 7/a

#### Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
- d) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një veprë penale;
- e) të mos jetë larguar nga detyra për shkakë disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- f) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

- a) vjetërsisë në profesion;
- b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese ose Gjykatës së Lartë;
- c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
- d) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
- e) curisur gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlerëshme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
- dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

4. Organet e emërtësës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore. Kërkesa dhe dokumentat shoqëruese mund të dorëzohen me postë ose drejtpërdrejtë në ambientet e Institucionit të Presidentit të Republikës, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1 Tiranë, Kodi Postar 1001.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm, është brenda datës 26 nëntor 2018.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikantëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës dhe me jetet e informimit publik, dhe menjëherë dosjet respektive për secilin aplikant do t'i përcillen Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vlerësim sipas ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës, do të bëjë transparente çdo rezultat të këtij procesi në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr.8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Për çdo sqarim mos hezitoni të kontaktoni në këto të dhëna kontakti:  
Numri telefonit: 042389898



Publikohet në Fletoren Zyrtare lista me personat që u është njohur e drejta për kompensim

# Dosjet 1993-2013, lista me 611 pronarët që marrin paratë

## Përfituesit në të gjithë vendin, ja si do të paguhen

**A**gjencia e Trajtit të Pronave publikon listën e 611 me pronarët që kanë aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilën dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje të cilave Agjencia e Trajtit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të dosjeve dhe pronarët që nuk janë njohur me vendimin duhet t'i drejtohen gjykatës.

**KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK**  
Sipas formularëve-tip, mësohet se kërkuesi duhet të

cilësojë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të parqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i vlerësimit të tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndry-

shuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numer logarie, vërtetim nëse subjekti ka përfutuar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

### LOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerësimit të tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të

kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompen-

sohet fizikisht, nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuara u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

### LISTA ME 611 PRONARËT QË MARRIN PARATË

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkues)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Tiranë	MEZEZI	2990	7410
Tiranë	GANI BALIU	3050	17655
Tiranë	Fatmir Bastani	6751	2266
Durrës	Hamid Berberi	2502	1120
Durrës	Bejtulla Ndreu	920	700
Durrës	Lulezim Dallaku	680	1628
Durrës	Demir Subashi	3100	807
Durrës	Xhemile Parruca	770	631
Durrës	Qamil Veseli	4870	1080
Durrës	Bedrie Caca	2230	440
Tiranë	ALI LAMA		942
Tiranë		10000	3459
Korçë	Sybi Agastra	1096	500
Vlorë	Tahir Hoxha	1622	196
Vlorë	Luiza Spiro	1803	160
Vlorë	Vaide Berberi	100	2540
Vlorë	Resul Shino	3075	4125
Korçë	Haxhi Mancelli	1912	327
Korçë	Niko Melonashi	835	299
Tiranë	MURAT LUGA	5000	15000
Shkodër	Hiqmet Bekteshi	590	410
Gjirokastrë	trashëgimtarët	1074	528
Durrës		5000	3000
Durrës		291	681
Korçë	Hekuran Shaholli		60
Korçë			200
Durrës	Vangjel Gjyshmama	60	68
Elbasan	HYSEN SALIU	1788	2512
Tiranë	MAHMUT SELIMI	5500	4200
Korçë		550	4000
Korçë			618
Korçë			29.2
Elbasan	ELI STAFA	1980	400
Shkodër	Lazer Sime Corri	1600	8460
Shkodër	Mark Gjon Zefi		0
Shkodër	Gjoke Mark Tanushi		0
Kukës	Ramiz Hoxha	969	700
Lezhë	Geg Kol Biba		3546
Lezhë	Trashëgimtarët Nikolli		8333
Vlorë	Beqir Kongjinaj	2027	0

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkues)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar	
Shkodër	Zeqir Ragip Sykja		2300	
Shkodër	Xhevat Sait Hallunaj		0	
Shkodër	Lula Zef Gruda		0	
Elbasan	SHEFQET PENI	2860	500	
Lezhë	Mark Ndue Tuçi	3242.5	6757.5	
Lezhë	Bardhok Haçi		15082	
Shkodër	Servete Shehu	971	3326	
Korçë	Feim Maliq Saliq		913	
Korçë			6000	
Korçë	Sotirag Abeshi		15	
Korçë			1000	
Tiranë	RAMIZ SARAÇI	5635	7789	
Berat			5150	
Korçë	Myrteza Stergo	1287	466	
Korçë		704	1704	
Elbasan	HAMIT CELA		12790	
	Gjirokastrë	Harrila Kovi	790	230
Elbasan	ADILE DEMIRI		32	
Elbasan	NAIM CERRIKU	13000	2625	
Shkodër	Instituti Eterit Jezuite	3230	156	
Tiranë	Vilma Katrosi	10000	21730	
Tiranë	MUHARREM VISHA	5000	15000	
Shkodër	Familja Curani	556	7	
Elbasan	OSMAN HEKURANI	5000	15370	
Fier	Daut Hoxha	4500	10656	
Fier	Haki Malaj	900	200	
Fier	Hasan Murrizi		5000	
Tiranë	TRASHGIMTARET PETRELA		49	
Tiranë	TRASHGIMTARET PETRELA	225	1568	
Shkodër	Geg Pali	1280	952	
Shkodër	Anton Prendushi	556	7	
Korçë			56	
Korçë	Jorgjeta Risto		33	
Gjirokastrë	Hajri Mezini		1220	
Vlorë	Eftalia Dalda	195	2514	
Vlorë	Stavro Kallojeri	981	19	
Tiranë	RIZA MURATI		126	
Dibër	ALUSH SELASI		0	
Vlorë	Ilia Jorgji Zoto	2073	17	
Shkodër	Aleme Muriqi	6736	270	
Shkodër	Niza Kullolli		0	

Fier	Sulejman Manoku		3500
Shkodër	Ahmet Basha	569	233
Tiranë	Myhyrije Cara		10150
Tiranë	HASAN ÇAÇA	700	4125
Korçë	Qemal Sabri	100	598
Elbasan	SABRIHEDIN, HISEN, ELIHA DARRATI	2662	988
Korçë	Viktor Pire	399	85
Korçë	Qazim Burimi	7220	3530
Korçë	Leonidha Bendo		220
Gjirokastër	Luftir Ismailaj	2435	394
Tiranë	XHAFERR PETRELA	8500	500
Tiranë	OSMAN MUÇA	4050	6150
Tiranë	IZABELA PANOTI	8834	1996
Korçë		690	543
Tiranë	TRASH. DERSHVI DERSHVI	1535	1462
Tiranë	Shaban Mara	400	4500
Korçë	Dervish Jazhxi		2144
Korçë	Pellumb Skenderi	2115.08	10988
Dibër	Luan Kuka	1321	3413
Korçë		1979	327
Korçë		203	1116
Fier	Shaho Kapaj	800	4000
Tiranë	Haxhi Pellumbi	252	1688
Elbasan	SASHENKA TIRANA	3350	6200
Vlorë	Malo Hyseni	240	160
Fier	Rizvan Bali		2000
Fier	Hysni Bali		4480
Tiranë	QAMIL TOPI	1485	3207
Elbasan	Hasan Kamami	5000	7910
Tiranë	Abaz Adem Hoxha		11200
Durrës			2200
Durrës	Ali Hasan Halili	6510	3140
Fier	Selim Cela		6648
Shkodër	Lula Gjon Margilaj		4500
Shkodër	Mark Kercaj		6170
Fier	Kujtim Kurti		15700
Fier	Hajdar Sherifi		1320
Fier	Gezim Teki Libohova		5049
Korçë	Viktor Konini	66	805
Tiranë	QAMIL PALANIKU	20000	41593
Fier	Havri Peshani		10460
Vlorë			1388
Vlorë	Mustafa Hoxha		315
Elbasan	ISMAIL BAJRAMAJ		256
Tiranë	JAKUP KOKONOZI		21771
Tiranë	PAULIN KOCOBASHI		301.3
Korçë	MEHMETALI KUCI	2200	800
Korçë	Agron Koprëncka	1399	2101
Korçë	Mentor Doko	3190	7044
Korçë	Ramadan Haxhi	5595	1925
Tiranë	SKENDER, HAXHI SAUKU	632	507
Tiranë	XHEMAL BRARI	3705	495
Tiranë	XHEMAL BRARI	1142	5758
Tiranë	AGIM PREZA	1685.3	13614.7
Berat	ENGJELL SATKA		500
Durrës	Muharrem Tahiri	1887	430
Tiranë	IBUSH MALIQ BERISHA		1809
Durrës			1125
Durrës	Hasan e Hysen Derveni	840	1547
Durrës	Qamil, Xhevid Merlika		0
Durrës	Sabri Hoxha	3518	0
Durrës	Mustafa Kota	721	1824
Durrës	Bukurie Dibrani	148	0
Elbasan	MUST AFA SELMAN KISHTA		5794
Elbasan	HYSEN KURTI		2685
Elbasan	BASHKIM BALLIU	1080	24738
Korçë	Emine Ibrahim		5218.5
Dibër	Selim Dervishi	1500	5500

Dibër	HALIT DERSHVI	1500	5500
Dibër	HYSEN DERSHVI		7000
Tiranë	SHPETIM, GEZIM, ZYRA KARAJ	859	3912
Tiranë	MAKRINA MIHO	120	277
Dibër	GANI DERSHVI	1500	5500
Elbasan	BURBUQE GJERMAKU	4700	1520
Elbasan	NDRICIM PITJA		46
Elbasan	RUKIJE ABDURREZAKU	150	474
Korçë	Grigor Mulla		2100
Dibër		1482	618
Dibër	Hysen Ndreu		0
Dibër	AQIF DODA	5571	1740
Tiranë	KOL PEMA		720
Tiranë	TONIN KERMIQI		747
Korçë			0
Elbasan	SANE ZABELI		405
Elbasan	XHEVRIE XHEMAL HALILI	200	407.25
Vlorë	Azbi Xhini	700	4291
Korçë		650	666
Korçë		1534	1500
Elbasan	BEJAZE MUZHAQI	316	2376
Elbasan	RIZA SALI XHELO		5102
Elbasan	LIVAN ELEZI		10157
Elbasan	SHKELQEN ZIKA		1975
Elbasan	SADIK LUBONJA		1173
Elbasan	ISUF XHAFERRI		5722
Tiranë	HAXHI ETJ LEÇINI		360
Tiranë	HAXHI ETJ BERISHA	718	2282
Tiranë	HAVA ETJ BELBA		3000
Tiranë	REXHEP DULE		1685
Durrës	Hafize Kalari		7000
Elbasan	MUSA XHEPA	165	3635
Tiranë	ALUSH HOVI		10600
Korçë	Eqerem Isallari	2900	7515
Korçë	Bexhet Isallari	1720	5480
Korçë	Adriatik Doko	1596	1845
Korçë			1260
Shkodër	Bardhyl Lika	1125	1179
Durrës			647
Elbasan	HASIM HIDA		1446
Elbasan	SHAHE CEKREZI		1366
Dibër	XHEVAT DUMANI		142
Dibër			4417
Elbasan	MISIR RREGU		2830
Dibër	Sali Zogu		632
Dibër			0
Durrës	Vangjel Gjyshmama		551
Durrës	Teodor + Kristina Bixhi e Trungu		306
Elbasan	JORGJI PANARITI		22
Fier	Hasan e Guri Sefa		0
Korçë	Komiteti Bektashian		5000
Vlorë	Feim Rustemi	1123	170
Vlorë	Nazif Damani, Veziko Memeti	938	419
Vlorë	Nuri Sharra		840
Vlorë	Shemsho Hado	2633	1208
Lezhë	Dod Pima		1800
Tiranë			300
Tiranë	QEMAL GAVARDARI	173	255
Korçë	Ali Qiraxhi	9100	896
Shkodër	Kolec Simoni	1394	3598
Elbasan	ISLAM DAUT QOSHI		1200
Vlorë	Zaharia Kocelano	310	210
Vlorë	Agush Lazaj		750
Elbasan	NAZIF POPA		9250
Elbasan	XHEVIT MESATI		7063
Elbasan	DAPE RABO		3500
Elbasan	AFERDITA SALIU	549	396
Durrës			1384

Fier	Pandi Ndini		10000	Vlorë	Ndreko Kaci	240	600
Fier	Murat Xhepexhin		6200	Tiranë	KATERINA MIHALI	1432	3651
Dibër	Nurçe Murra		1642	Tiranë	RIZA XIBRI	5000	18220
Gjirokastrë	Petrit Rexhepi	5000	3144	Fier	Shyqyrie Psatha		3010
Gjirokastrë		108	1930	Fier	Luan Licka	5000	10500
Gjirokastrë	Miti Pilo Ballabani	2990	798	Durrës			2383
Gjirokastrë	Myftar Aliu	3564	4306	Vlorë	Perlat Lushaj		2750
Korçë	Remzi Dervishi	2083	1697	Shkodër	Kole Filip Kovaçaj	3975	0
Korçë	Remzi Dervishi	2083	1697	Vlorë	Lono Qiriaçi		0
Elbasan	FATUSHE IBERSHIMI	200	360	Tiranë	MUHARREM GUDALLA	270	0
Vlorë	Thanas Prifti	1270	700	Vlorë	Luan Cakëri	1283	7117
Korçë		808	908	Dibër	Ramiz Kasmi		2400
Tiranë	HAMDI MURTHI	26775	15725	Shkodër	Simon Lano Hila		650
Vlorë	Mitro Bakalli	390	0	Shkodër	Pjeter Ndoc Marku	2850	0
Tiranë	YMER CERLOI		980	Tiranë	LIRI TASHKO	1528	407
Durrës	Astrit Kadilli	42	85	Tiranë	FADIL XHAFA	3970	0
Tiranë	AFERDITA KASA	320.7	448.3	Tiranë	SEVIM PESHKEPIA		305
Durrës	Petrit Zenel Cela	622	0	Korçë		1821	2038
Fier		280	1442	Tiranë	TEFTA KERENXHI	84	209.6
Fier	Kadri Kodheli		4000	Shkodër	Leke Fran Preka		0
Fier	Toli Sholi	7620	2630	Fier	Myftar Buzi		2100
Shkodër	Vincenc Gjonaj	3680	620	Shkodër	Rrok Kol Marashi		0
Shkodër	Eljaz Barbullushi	430	194	Korçë	Xhaferr		625
Shkodër	Zef Muzhani	755	2724	Korçë	Vangjel Marko	768.5	1144.5
Gjirokastrë	Nikolla Praso	200	2042	Gjirokastrë	Lili Andon		750
Durrës		9820	1480				
				Vlorë	Dhionis Çili	635.4	2893.6
				Vlorë	Brahim Tafili	250	550
				Vlorë	Bajram Nuhaj, Dile Nuhaj		618
				Vlorë	Pandeli Janina	140	1339
				Fier	Andrea Papaj	3483	37517
				Korçë	Gezim Kondo		1014
				Korçë		806	7798
				Tiranë	FERID KAZANI	2632	1193
				Tiranë	SALI NJAZI DEDE		0
				Tiranë	SALI NJAZI DEDE		0
				Tiranë	SALI NJAZI DEDE		0
				Vlorë	Mystehak Idrizaj, Gëzim Jazaj	16301	974
				Vlorë	Mehmet Pashaj		1586
				Elbasan	YMER BALLABANI		4830
				Elbasan	HASAN LLAHA		1679
				Elbasan	ISMAIL ZENUNI		4200
				Elbasan	ISLAM KRYEMADHI		3000
				Elbasan	JASHAR BALLIU		1929
				Elbasan	MEHMET MECE		1008
				Elbasan	AGIM MECE		1150
				Elbasan	SKENDER MAMA		1028
				Elbasan	LIVAN DERVISHI		1100
				Gjirokastrë	Klanthi Nace	373	327
				Korçë	Gjerdan Llabanari	664	1101
				Tiranë	ALI EMIRI	223.5	427.5
				Tiranë	ALI EMIRI	223.5	427.5
				Dibër			593
				Dibër	Shaban Krusa		1222
				Dibër	JASHAR BEXHET BAJRAMI		1740
				Durrës			3872
				Lezhë	Xhemal Baftjar Koleci		0
				Kukës	Basri Shani Elezi		0
				Elbasan	HASAN ST AFA		4000
				Elbasan	GANI OMERI		4343
				Korçë		7858	2724
				Korçë		800	225
				Fier	Beqir Xhindole	200	10800
				Fier	Hekuran Musai		7200
				Fier	Ilia Shyti		6000
				Fier	Anerit Taka		5000
				Korçë			1150

(vizon)

Dosja "Titanik 2", kryetari i PDSH dënohet bashkë me ish-kreun e shërbimit sekret të Maqedonisë

# Manipulim votash, 3 vjet burg Menduh Thaçit

## Fajtor për parregullsi zgjedhore të zgjedhjeve lokale të vitit 2013

Gjykata Penale në Shkup ka dënuar me tre vite e dy muaj burg kreun e PDSH-së, Menduh Thaçi. Po ashtu, me tre vjet burg është dënuar edhe ish-kreun i DSK-së, Shasho Mijalkov.

Ky është aktvendimi për rastin "Titanik 2", gjegjësisht për parregullsi zgjedhore të zgjedhjeve lokale të vitit 2013, e cila dje është lexuar nga gjykatësi Ognen Stavrev.

Mbrojtja në fjalët përfundimtare ka kërkuar aktvendim lirues për gjithë të akuzuarit, duke theksuar se Prokuroria nuk ka dhënë prova me të cilën vërtetohet vepra për të cilën ngarkohen.



Menduh Thaçi

Avokatët mbrojtës kanë pasur vërejtje edhe në besueshmërinë e audio incizimeve që siç thanë, "janë përfutur jo ligjërishit". Kanë thënë se akuzat është ngritur nga paditësi i paautorizuar, pra është pas skadimit të periudhës prej 18 muajsh, e caktuar sipas akuzës së PSP-së.

Sipas PSP-së, Mijalkov si drejtor i DSK-së dhe anëtar i Komitetit ekzekutiv të VMRO-DPMNE-së e ka shfrytëzuar ndikimin e tij real dhe përmes Menduh Thaçit ka dakorduar të miratohet ankesat për rivotimin në tre vendvotime në Strumicë në zgjedhjet lokale 2013. Anulimi i votimit, sipas

### AKUZA NDAJ THAÇIT

Mijalkov si drejtor i DSK-së dhe anëtar i Komitetit ekzekutiv të VMRO-DPMNE-së e ka shfrytëzuar ndikimin e tij real dhe përmes Menduh Thaçit ka dakorduar të miratohet ankesat për rivotimin në tre vendvotime në Strumicë në zgjedhjet lokale 2013.

Fetait është përlllogaritje ekzakte e VMRO-DPMNE-së se sa nevojitet që kandidati i tyre të mund të shkojë në rrethin e dytë, derisa Thaçi edhe pse nuk ka pasur të drejtë ligjore e ka bindur Bedredin Ibraimin të pranojë mendi-



### APELI I SHBA

## David Hale: Të vazhdojnë bisedimet Kosovë - Serbi

Zv/sekretari amerikan i Shtetit, David Hale, u bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë të ndërpresin provokimet dhe të rihapin bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre. Hale takoi të premtën në Beograd presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për të diskutuar rrugët e vazhdimet të bisedimeve që janë pezulluar për shkak të refuzimit të Serbisë për vazhdimin e tyre pa heqjen e tarifave ndaj mallrave serbe që u vendosën në nëntor të vitit të kaluar nga qeveria e Kosovës. Në një njoftim të ambasadës amerikane në Beograd pas takimit thuhet se "Shtetet e Bashkuara bëjnë thirrje për heqjen e tarifave, ndërprerjen e provokimeve të dyanshme dhe vazhdimin e bisedimeve. Shtetet e Bashkuara vlerësojnë partneritetin me Serbinë dhe dëshirojnë të ndërtojnë marrëdhënieve edhe më të fuqishme" thuhet në një njoftim të publikuar në rrjetin Twitter.

min e tij dhe të votojë për ankesat e VMRO-së, ndërsa për kthim siç ka sqaruar Fetaj, anëtarët e KSHZ-së nga VMRO-DPMNE duhej të votonin për ankesat e PDSH-së në Çair.

Të akuzuarit e tjerë, anëtarët e KSHZ-së, sipas PSP-së e kanë keqpërdorë detyrën zyrtare dhe nuk kanë qenë në funksion të Kodit zgjedhor, por të interesave partiake.



**Tirana International Airport**  
Nënë Tereza

### TENDER NOTIFICATION

**STAFF TRANSPORT SERVICES  
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is looking to contract a company for the Staff Transport Services for Tirana International Airport for a period of two years with the possibility of renewal.

In order to obtain the necessary information for participating in this process, the interested parties need to write an e-mail to the following address: [srada@tirana-airport.com](mailto:srada@tirana-airport.com); [ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com); [apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com) specifying request for information for "Staff Transport Services".

The necessary instructions are delivered free of charge, electronically through e-mail. This tender will be organized in two phases:

- In the first phase, companies will need to present: references though similar services performed for other companies, list of vehicles, respective licenses.
- In the second phase, short listed companies will need to submit their financial offer.

Offers needed to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked 'Staff Transport for Tirana International Airport'.


The address for submission of offers is:  
**Tirana International Airport sh.p.k**  
Procurement Department  
Administration Building  
Rinas, Tirana  
Albania

The deadline for the submission of samples at the above address is **12:00 hrs. on 21 March 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:  
[srada@tirana-airport.com](mailto:srada@tirana-airport.com)  
[ialimema@tirana-airport.com](mailto:ialimema@tirana-airport.com)  
[apalushi@tirana-airport.com](mailto:apalushi@tirana-airport.com)

Tirana International Airport SHPK  
Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania  
Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545  
E-mail: [info@tirana-airport.com](mailto:info@tirana-airport.com) Website: [www.tirana-airport.com](http://www.tirana-airport.com)



**PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk**

Njofton se duke filluar nga data 9 Mars 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme është si vijon:

Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 09.03.2019 (përfshirë TVSH-në)
MARLBORO PREMIUM BLACK KS BOS 20	500 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS LCB 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS BOX 10	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 10	320 Lekë/paketë
MARLBORO FLAVOR PLUS (FWD) KS SRP 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (4 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (6 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.0) 100 RCB 20 XSL	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.5) 100 DSP 20 SSL	280 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS BOX 20	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS RCB 10	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS SLIMSMAG 100 RCB 20 XSL	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC6M KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC4 KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
MERIT BIANCA 100 BOX 20 SSL	220 Lekë/paketë
MERIT (ORANGE) KS RCB 20	230 Lekë/paketë
L&M RED LABEL KS RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 4MG RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 6MG RCB 20	220 Lekë/paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i ndryshuar).

**PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk**  
Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,  
1000 Tirana, Albania  
Tel: +355 42 276 670

# BLUE TOOTH

Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 651

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHOIPTARE Redaktore: Enida HIMAJ - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 9 Mars 2019

E lidhur me ish-futbollistin italian,

## JORI DELLI:

**"SIMONE ISHTE SHUMË XHELOZ  
POR TANI MË BËN FOTOT ME BIKINI"**



**Flet modelja me origjinë shqiptare:  
Babi ka bërë 3 punë të rëndomta, uroj  
t'ja shpërblej një ditë. Si u bëra pjesë e  
"Sport Italia" dhe karriera ime si modele**

## 8 MARS

**Vipat urojnë  
të shtrenitët  
e tyre dhe  
femrat**



**Nga Anjeza  
Shahini tek Xhensila  
Myrtezaj, postimet  
e të famshmëve  
për festën**



Flet modelja me origjinë shqiptare: Babi ka bërë 3 punë të rëndomta, uroj t'ja shpërblej një ditë

# Rrëfëhet Jori Delli: Si u bëra pjesë e "Sport Italia" dhe karriera ime si modele

*"Simone ishte shumë xheloz por tani më bën fotot me bikini"*

Pamela Aliaj

Ajo është një nga modellet më të përfolura në mediat italiane dhe më gjerë. Në një moshë tepër të re bukuroshja me origjinë shqiptare arriti të ishte pjesë e një kasti shumë të njohur të emisioneve sportive në Itali, "Sport Italia". Modelja shqiptare prej vitësh jeton në Torino të Italisë. Jori Delli mori famë në Itali pas promovimit

në programin "Prive" të "Sport Italia", verën e 2018. Pas programit, ajo ra në sy nga mediat italiane dhe këtë e tregonin kopertinat e shumta të revistave për të cilat ajo pozonte. Me një trup perfekt dhe me pozat super seksi dhe joshëse, 23-vjeçarja s'kishte se si të mos tërhiqte vëmendjen e italianëve. Në pak muaj shqiptarja u vodhi zemrën teleshikuesve, aq shumë sa

është shndërruar në një nga fytyrat e femrave më të vlerësuar të botës së sportit. Por kush është Jori Delli dhe cila është historia e saj dhe e prindërve të saj? Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Jori na rrëfen prapaskanat e pjesëmarrjes së saj në "Sport Italia", lidhjen e saj me ish-futbollistin italian Simone Camolese, i cili tashmë është pronar i "Cacun Premium



zimi për të qenë pjesë e tyre?

Isha pjesë e konkursit këtë verë nëpërmjet agjentit tim dhe arrita të isha pjesë edhe unë. Iu pëlqeva shumë dhe pas disa ditësh isha pjesë e televizionit me ta.

Vijoni shkollën për inxhinieri tek politekniku i Torinos, jeni gazetare tek Sportitalia dhe modele njëkohësisht. Ku e shihni veten më tepër në të ardhmen?

Prioriteti im qëndron gjithsesi të përfundoj universitetin. Më pëlqen të punoj në televizion dhe më argëton shumë. Nëse do të kem mundësinë ta kthej në një punë afatgjatë do të isha mëse e lumtur, por e vetmja siguri që më mbetet është universiteti.

Jeni lindur e rritur në Itali por me familje shqiptare. Si ka qenë historia e tyre për të arritur aty ku janë sot?

Prindërit e mi kanë qenë të

Vodka". Gjithashtu Jori na rrëfen edhe sekretin e linjave të saj perfekte dhe karrierës si modele. Për ta njohur më tepër bukuroshen me origjinë shqiptare ndiqni intervistën e mëposhtme:

**Jeni një nga modelet më të përfolura në Itali për pjesëmarrjen tuaj tek Sportitalia si imazh tepër tërheqës. Si erdhi propo-**



parët që kanë emigruar nga Shqipëria pas regjimit komunist. Babi im ishte i pari që mbërriti e pas një viti erdhi dhe mami. Babi im sapo arriti në Itali nisi të punonte dhe bënte tri punë të rëndomta në të njëjtën kohë. Jam krenare për ta dhe shpresoj që një ditë do të mund t'i shpërblej një milion herë për atë që kanë bërë për mua.

**Sa e vështirë ka qenë për të arritur atë që keni në një vend ku jeni emigrante siç është Venezia?**

Unë kam lindur në Venezia dhe nuk kam patur asnjë lloj diskriminimi. Që kur kam qenë e vogël, të gjithë më donin shumë.

**Modelingu është vetëm pasion i juaji apo edhe më tepër se kaq?**

Bëj modeling sepse është një punë që më lejon të fitoj diçka por në të njëjtën kohë nuk më kufizon me oraret, kështu që mund të studioj.


**Çfarë dëshirash apo pasionesh të tjera ka Jori, përveç modelingut?**

Më pëlqen të bëj sport e të jem në formë. I jap shumë rëndësi formës fizike jo vetëm për të punuar si modele por për një çështje personale. Ushtrohem shpesh dhe më bën të ndihem mirë. Dashuroj edhe detin. Kam një licencë zhytjeje dhe po bëj një të dytën.

**Jeni e dashura e ish-futbollistit, Simone Camolese. Si nisi historia juaj? Si u njohët?**

Jemi njohur rastësisht në një disko dhe mua në fillim nuk më pëlqente fare. Ai është pronari i një firme vodke, dhe për të më bërë për vete më kërkoi t'i bëja si modele.

**A është xheloz lidhur me fotot e tua promovuese e tepër seksi në**



**Instagram? Të ka thënë të fshish ndonjë?**


Në fillim po, ishte shumë xheloz por më vonë u qetësua dhe e kuptoi rëndësinë e rrjeteve sociale për punën time. Tani është ai që më bën fotot me bikini.

**Jori është një modele e cila është përfshirë shpesh në mediat italiane por edhe ato shqiptar, me pamjen e saj. Çfarë bëni për të patur një trup të tillë?**

Ha mirë dhe ushrohem shpesh. 3 herë në javë minimumi ushrohem në palestër. Ndiqem edhe nga një trajner personal.

**Çdokush punon për të arritur më të mirën e vetes në jetë. Cili është synimi juaj Jori? Çfarë obiectivi i keni vënë vetes?**

Obiectivi im është të jem e lumtur. Sigurisht jam duke u përpjekur të krijoj një të ardhme që të më jap një stabilitet ekonomik.



Nga Anjeza Shahini tek Xhensila Myrtezaj, postimet e të famshmëve për festën

# Vipat urojnë 8 marsin të shtrenjtët e tyre dhe femrat kudo ndodhen

## *Frymëzuese dhe inkurajuese, mesazhet më të ndjera të njerëzve të njohur*

Pamela Aliaj

8 Marsi është një nga ditët më të bukura të festuara ndërkombëtare shqiptare. Nëpër botë ajo nuk mund të quhet në kuptimin e plotë të fjalës 'festë' por është një ndërgjegjësim për femrat nëpër botë që ato të kërkojnë të drejtat e tyre, të mos jenë të shtypura dhe të ecin përpara në një botë të tillë me kaq shumë vështirësi, pabarazi dhe shtypje. Ideja për "Ditën Ndërkombëtare të Gruas", u hodh fillimisht në fillim të shekullit të XIX-të, e cila ishte një periudhë e tronditur nga trazirat dhe shtimi i popullsisë, për botën e industrializuar. 8 marsi njihet si "Dita e Gruas", në të gjithë botën. Madje në shtete të ndryshme kjo ditë festohet si festë kombëtare. Kjo ditë shërben jo vetëm për bashkimin e grave pa dallim feje, race, kulture, gjuhe dhe prejardhjeje, por edhe për të kujtuar përpjekjet për barazi, paqe, drejtësi dhe ndërtim në gati 9 dekada. Ndërkaq në Shqipëri festohet dhe shumë vip-a të njohur japin mesazhet e tyre edhe për këtë vit për femrat e jetës së tyre dhe për të tjerat kudo që ndodhen. Nga Anjeza Shahini e cila u bë nënë për festën e 8 marsit e deri tek Xhensila Myrtezaj, ndiqni disa nga mesazhet më emocionuese të njerëzve të famshëm këtë vit.

### DIELLZA KOLGECI

Nuk të bën feministin festim ose mos festimi i 8 marsit. Urime për 8 marsin juve gra të forta, juve që e përkrahni njëra-tjetrën, juve që luftoni për të drejtat e grave dhe ngriheni kundër padrejtësisë, juve që nuk paragjykonin dhe bëni bla-bla por veproni duke ndihmuar ato që nuk e kanë fuqinë tuaj. Por për këtë festë i uroj edhe gjithë ata burra, baballarë që vajzat e tyre i rritin duke i mësuar se si të jenë të pavarura, si të luftojnë për atë që duan, si të mbrohen prej padrejtësive dhe mbi gjitha si të guxojnë të jenë VETJA. Festo si të duash, unë edhe këtë vit zgjedha të festoj duke ndihmuar ato që kanë nevojë për ndihmën tonë.

### ARIANA FEJZULLAHU

Ariana Fejzullahu, bashkëshortja e këngëtarit të



mirënjohur, Ermal Fejzullahu, i ka uruar vjehrrës dhe nënës 8 Marsin, Ditën Ndërkombëtare të Gruas. Ajo ka bashkuar dy fotografi të bukura të nënës dhe vjehrrës, ndërsa ka vënë një urim të veçantë. "Dy princesha. Ju uroj nga zemra, Gëzuar 8 Marsin Ditën Ndërkombëtare të Gruas", ka shkruar Ariana krahas fotos në Instagram.

### ANJEZA SHAHINI:

Këngëtarja e njohur, Anjeza Shahini këtë ditë e feston për dy arsye: si femër dhe si nënë për herë të parë. Ajo ka sjellë në jetë në festën e 8 marsit, vogëlushen e saj Vik-

toria. "Dita e parë e grave për mua si një nënë.. Përhëndëteni vajzën time TORI (Victoria Kelis Connolly) Këtë vit festoj ditën e gruas si një mami e një vajze të vogël sa një gogël që quhet TORI (Victoria Kelis Connolly)", ka shkruar Anjeza në Instagram.

### SARA HOXHA:

Ditën e djeshme Sara Hoxha ka zgjedhur vetëm pak fjalë për të shprehur vlerësimin për nënën e saj. Ajo ka publikuar në 'Instagram' një foto të veçantë të mamës së saj ditën e martesës. Në foto dallohet zonja Vjollca me një fustan tepër elegant në

dasmën e së bijës me fustanin e Sarës në duar. Ditën e djeshme ajo zgjodhi pikërisht këtë foto për të uruar ditën e femrave. Për Sarën gruaja model, është vetë nëna e saj dhe këtë na e tregoi në postimin e saj më të fundit.

### AURELA GAÇE:


Të dashura ne jemi të bukura ashtu siç jemi sepse trupat tanë kanë mbajtur jetën e re, zoti na ka bekuar me këtë mundësi. Ne duhet të jemi të shëndetshme, të forta për fëmijët tanë. Të jemi të lumtura për vetë, për familjen dhe shoqërinë. Me sport më besoni që çlironi energjitë neg-

ative që duam s'duam i marrim sepse jemi njerëz. I bëjmë shërbimin më të mirë shëndetit tonë. Edhe fëmijëve ju japim forcë të mos dorëzohen për asgjë në jetë. Mos lejoni asnjë t'ju tregojë të kundërtën. Ne nënat jemi të bukura me çdo shenjë në trup, me celulit, me tulle. Zoti e di pse na e dha ne këtë mundësi, sepse e di ai që ne jemi luanesha.

### ALTUNA SEJDIU (TUNA):

Unë jam krah vajzave që flasin pistë. Ato me këmbë të zbatshura, mendje brilante, flokë të shpupuritura, zemra të egra dhe plot gjallëri. Me ato që nuk frikësohen të fla-





sin dhe që jetojnë për të bërë atë që u është thënë se është e pamundshme! Me ato që nuk kanë frikë të ngrenë zërin...unë jam me ju Chongas...Le t'i mbështesim femrat e këqija.

**ROZANA RADI:**

Në të gjitha jetët po të më kthenin përsëri do zgjidhja të isha grua. Në fund të fundit, ne dimë mirë se suksesi apo dështimi varet vetëm nga vendimet që ne marrim. Kam mësuar të mos i dëgjoj mendimet e atyre që nuk kanë përvojën e duhur, por dëgjoj vetëm ata, të cilëve u kam kërkuar një këshillë. Nuk

kënaqem kurrë me pak. Nuk kam frikë që zëri im të dëgjohet. Nuk kam nevojë për një burrë për t'u ngjitur në karriere. Jeta na ka mësuar të vazhdojmë përpara dhe pse ka qenë e vështirë. Mos ja lejonit kurrë vetes të jeni opsion i një burri. Dhe mos lejonit plagët që keni marrë në jetë t'ju transformojnë në dikë që nuk jeni.

**EMINA CUNMULAJ:**

Unë në fund të fundit mendoj se një femër që nuk e respekton veten, që nuk tregon vetveten, nuk do ta respektoj as maskulli. Edhe pastaj ti nuk e ndjen veten te fu-

qishme, nuk e ndjen veten mirë, ti je sepse ai të ka bërë. Unë jam ajo që jam, sepse ja kam dalë vetë. Është krenaria dhe gëzimi im. Nuk jam kështu për shkakun tënd, apo sepse ti më dhe diçka. Nuk kam nevojë t'i them askujt faleminderit, përveç vetes.

**ORGESA ZAIMI:**

Djeka shumë presion mediatik apo edhe shoqëror për femrat menjëherë pasi lindin qofshin persona publik ose jo. Ç'është kjo mani kaq e madhe dhe gati-gati shantazhuere që menjëherë pasi lind duhet të jesh më e dobët se më parë. Mund t'ju them

me bindje se këtë herë të dytë pas lindjes nuk kam ndërmend të strapacohem edhe pse këtë herë kam rënë vetë në mënyrë natyrale në peshë, mbase sepse të kesh dy fëmijë të vegjël të bën të harxhosh shumë energji. Dua t'u them të gjitha femrave që mërzhiten nëse nuk dobësohen pas lindjes ose kanë merak; Hani çfarë të doni dhe shijojeni këtë periudhë sepse nga pesha bie për një muaj, por qumësht nuk prodhon dot gjithë jetën...Ne sjellim jetë, kemi nevojë për më shumë kile. Fuqia e gruas.

**ORINDA HUTA:**

"Ma nxorre shkumën moj vajzë"...Tani nuk ndodh më ta thuash, përkundrazi, por unë e di që të kam lodhur shumë sepse kam qenë vajzë rebele dhe nuk e çaja shumë kokën. Ti më ke dashur shumë gjithmonë dhe shpesh herë jam ndërje si e preferuara, edhe pse të ngacmoja se doje më shumë djalin. Unë nuk njoh grua më të fortë, më të mirë dhe më të dashur se ti. Faleminderit zotit që të kemi.

**ENO POPI:**

Rreth dy vite më parë nëna e moderatorit të njohur, Eno Popi, pas një sëmundje të rëndë, ndërroi jetë. Edhe pse Eno nuk është aktiv në rrjete ndërsa dje në ditën e gruas, na emocionoi të gjithëve me një dedikim prekës. Ai ka publikuar në 'Instastory' një foto, në të cilën shihet duke puthur dorën e nënës, me mbishkrimin: "Diku në parajsë ajo është duke qeshur".

**ENI ÇOBANI:**

Urimi fillon me mamën e shtrenjtë dhe i shkon të gjitha grave qofshin ngaherë të lumtura dhe plot mbarësi në jetën e tyre duke i falenderuar nga zemra gjithsecilën nga ju që pranuat të jem unë zgjidhja juaj. Ju dua shumë kudo që të jeni dhe mos rreshtni kurrë t'i thoni vetes që 'unë vlej'.

**BES KALLAKU:**

Gratë e jetës. mami Shpresa, më lindi, më dha jetë. Ija ime më rriti, më kripë për jetën. Xhensila ime më shtoi jetën dhe bashkë i dhamë jetë jetës. Bekimet e mia. Me fat jam. Ju dua. (Edhe Ana, motra ime, të dua shumë, nuk gjeta foto, sepse kisha dalë shumë keq vetë aty).

**DAFINA ZEQIRI:**

Femra është ajo që përkund ardhmërinë e një populli, urime për 8 Marsin, ditën e gruas. Çdo mbretëreshë ka madhësinë e saj, por madhështia e gruas është mbi të gjitha mbretëresha e botës!

**KLODIANA VATA:**

Je shembulli më frymëzues si një qenie mund të jetë gruaja perfekte, nëna e pakursyer, femra hyjnore, e brishtë dhe e hekurit, shoja më 'cool' dhe moderne, engjëlli besnik i familjes tonë. Gëzuar e bukura ime.

**XHENSILA MYRTEZAJ:**

Mam, të kam uruar gjithmonë për 8-Marsin, por nuk e kam patur ndjesinë kurrë sa sot. Të jesh nënë, e shenjtë si ty, si ju. Mam, urime shpirt, dhimbja dhe loti im. Krahët dhe përqafimi im, prehëri im dhe supi ku jam mbështetur për herë të parë. Faleminderit mam, për gjithçka. Faleminderit mami i Besit, Shpresa, më dhe djalin dhe ngrohtësinë që kisha shpresuar gjithë jetën. Përqafime dhe gëzuar për të gjitha nënat.

## Majk sërish në problem? Reperi ndalohet nga policia

Reperi i njohur Majk është ndaluar pasditen e djeshme nga policia e Kosovës. Sipas fotove të siguruar nga Gazeta Express, Majk ka zbritur nga makina e tij luksoze 'Porsche' ndërsa shihet duke pritur që policët të kontrollojnë mjetin. Kjo nuk është hera e parë që Majk haset me probleme të tilla, pasi edhe më parë është përfshirë në një aksident të vogël por shumë të komentuar.



## Kejvina largohet nga Xing me Ermalin, por kapen duke drekuar bashkë?

Pas lajmit të bujshëm për largimin e Kejvina Kthellës nga emisioni "Xing me Ermalin", mund të kemi një lajm të mirë. "Xing.al" raportonte dje se Kejvina e ka braktisur emisionin në mes të sezonit si pasojë e një konflikti me moderatorin Ermal Mamaqi, pasi nuk ka marrë vëmendjen dhe dedikimin e duhur nga ai. Por përmes një postimi të fundit në Instagram, Kejvina zbuloi se mbrëmjen e djeshme ka qenë për darkë në të njëjtin vend ku ishte edhe Ermal Mamaqi. Të dy kanë postuar nga i njëjti restorant, duke na bërë të mendojmë se ndoshta janë ulur për të biseduar shtruar në lidhje me qëndrimin e saj në emision. E pyetur nga iconstyle.al dje, velina nuk konfirmoi largimin dhe as qëndrimin në "Xing me Ermalin". Kur u pyet nëse është i vërtetë lajmi i largimit, bukuroshja bjonde u përgjigj "As po, as jo", ndërsa shtoi se nuk donte të fliste më shumë për këtë pjesë. Kjo na bëri të dyshojmë se vetë Kejvina nuk është e sigurt për largimin dhe madje mund të ketë sërish një rikthim, pasi Ermali t'i premtojë se do t'i kushtojë më shumë vëmendje!



## Elita Rudi shfaqet në super formë vetëm 3 javë pas lindjes së

### vogëlushit Zëri

Bukuroshja Elita Rudi qëndroi vetëm pak javë larg vëmendjes së ndjekësve në rrjetet sociale, për t'u rikthyer dje me një video të re pas ardhjes në jetë të djalit të saj Zëri, me partnerin Gjiko. Moderatorja dukej në superformë e veshur me një bluzë në ngjyrë të gjelbër dhe të zezë. Ajo kishte filmuar veten duke ecur ndërsa dhuroi edhe një buzëqeshje për fansat e saj. Ndërkaq që prej lindjes së vogëlushit, Instagramet përkatëse të reperit dhe moderatorës janë mbushur me foto të Zërit, madje janë hapur edhe shumë llogari në Instagram me emrin e tij.



## Mbyllen hetimet, ja 2 akuzat me të cilat do të përballlet Stresi në gjykatë

Ditën e djeshme janë mbyllur hetimet dhe është dërguar në gjykatë dosja për Arkimed Lushajn, i njohur për të gjithë me emrin e Stresi. Prokuroria ka kërkuar që Stresi të gjykohej për dy vepra penale, "armëmbajtje pa leje" dhe "trafik të lëndëve narkotike". Reperi gjendet në burg që prej tetorit, momenti kur u arrestua më 17 tetor 2018 pas një përgjimi të Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Ai ishte përgjuar teksa kishte thënë se ia kishte hedhur forcave Shqiponja pasi kishte hedhur armën në momentin kur ishin afruar efektive në afërsi të shkollës "Partizani". Pas këtij përgjimi në momentin ku i ekzekutohej kjo masë policia i gjeti në hotel edhe një armë tjetër. Historia e Stresit me drejtësinë është e njohur. Kohë më parë ai arriti të arratisë nga ambientet e komisariatit 3 në kryeqytet ku ishte shoqëruar për një vepër tjetër penale.

## DEBATI

"Kryeministri i Shqipërisë është një artist, diçka jo fort e zakonshme për një politikan. Edi Rama është piktor që i ekspozon punët e tij, por 12 muajt e fundit ai është përfshirë në një skandal mbi artin, sa i takon një çështjeje që i ka dëmtuar reputacionin dhe ka potencialin që të shkurtojë karrierën e tij politike

**T**ë Patri Kombëtar dhe Teatri Kombëtar Eksperimental, zënë vend edhe në lajmet e BBC. Gjigandi britanik BBC e ka cilësuar shembjen e godinave si çështjen që po fillon t'i kushtojë karrigen kryeministore një ish-artisti. Një gazetar ka ardhur në Tiranë për të përfshirë në një kronikë 5 minutëshe, citime nga kryeministri Edi Rama, ish-deputeti dhe Partisë Demokratike Albana Vokshi dhe një prej arkitektëve protesues, Kreshnik Merxhani.

Prezantimi i speciale nis me këto fjali: "Kryeministri i Shqipërisë është një artist, diçka jo fort e zakonshme për një politikan. Edi Rama është piktor që i ekspozon punët e tij, por 12 muajt e fundit ai është përfshirë në një skandal mbi artin, sa i takon një çështjeje që i ka dëmtuar reputacionin dhe ka potencialin që të shkurtojë karrierën e tij politike". Më tej, nis raportimi i gazetarit të mbërtur në Tiranë. Ai e nis raportimin duke thënë se është pritur në takim nga Edi Rama dhe përmend veprat e tij të artit. "Biri i një skulptori që bëri shtatoret e ish-diktatorit komunist, Enver Hoxha, ai vazhdon të pikturojë gjatë intervistës. Ai pikturon gjatë takimeve ndërsa muret e zyrës janë të mbushura me pikturat e tij shumëngjyrëshe", thotë gazetari i BBC.

Më tej, është kryeministri në sinkron. "Të bërit art është diçka që më ndihmon të mbaj veten të shëndetshëm" thotë shefi i qeverisë.

Gazetari kujton se dikur Rama ishte basketbollist i ekipit kombëtar dhe vë në dukje se në vitet komuniste sporti ishte një nga të paktat mundësi udhëtimi për të parë veprat e shekullit 20-të në muzetë perëndimorë.

Kur u bë kryeshkëmbi i Tiranës, thotë specialja e BBC, ai pikturoi pallatet komuniste me blu, lejla, jeshile e ngjyra të tjera. Por, në këtë pikë, gazetari prek çështjen e nxehtë.

"Prej një viti artistët po protestojnë në Tiranë kundër planit të Ramës për të shembur Teatrin Kombëtar dhe Teatrin Kombëtar Eksperimental që datojnë nga viti 1939. BBC ka intervistuar arkitektin që proteston për mbrojtjen e tyre, Kreshnik Merxhani, i cili thotë se është me rëndësi mbrojtja e teatrit, jo vetëm për vlerat arkitekturore që ai ka por edhe për vlerat e tij europiane".

Në kronikë sillel në vëmendje fakti që organizata si Europa Nostra kanë dalë në mbrojtje të godinave dhe se vetë Presidenti i Shqipërisë ka dalë kundër shembjes, duke mbrojtur vlerat e tyre arkitekturore, vlera të cilat Rama i krahason me veshje të aktore Violeta

# BBC: Shembja e teatrit do i shkurtojë karrierën, Rama: Varrezë historike

Reagimi i Aleancës: Deklaratat e kryeministrit janë skandalozë

Kronika e gjigandit mediatik britanik: Ai pikturon gjatë intervistës



Manushi, që tani nuk jeton më.

I pyetur për Teatrin Kombëtar nga BBC, kryeministri Rama thotë se "Ne nuk mund të përballojmë të kemi këtë varrezë të historisë në mes të qytetit. Duhet të ndërtojmë një teatër të ri atje siç bëhet kudo. Jo çdo gjë e vjetër vlen të mirëmbahet".

Një kompani është përzgjedhur për teatrin e ri që do të kushtojë shumë por qeveria nuk do të paguajë asnjë lek, thotë gazetari i BBC-së. "Kompania Fusha me të cilën Rama ka punuar disa herë në të shkuarën, do të paguajë për të. Në këmbim do të marrë një hapësirë prej 5 mijë metrash katrorë në qendër të Tiranës ndërsa 2 mijë metra janë të bashkisë. Kundërshtimet janë ezarruar falë një ligji special të njohur me emrin Ligji Fusha", thotë gazetari që më tej flet për takimin me (ish)deputeten Albana Vokshi nga Partia Demokratike. "Ka rreth 6 ndërtime dhe përfitimet në bazë të përlogaritjeve tona shkojnë deri në 205 milionë euro". Sipas saj, ka diçka që e lidh Fushën me qeverinë. Kur

## KRAHASIMI

Në kronikë sillel në vëmendje fakti që organizata si Europa Nostra kanë dalë në mbrojtje të godinave dhe se vetë Presidenti i Shqipërisë ka dalë kundër shembjes, duke mbrojtur vlerat e tyre arkitekturore, vlera të cilat Rama i krahason me veshje të aktore Violeta Manushi, që tani nuk jeton më.

gazetari e pyet nëse ajo beson se është marrëveshje korruptive (kjo për teatrin) dhe se disa, paratë që i janë dhënë Fushës po kthehen tek ata që kanë ndihmuar për kontratën-Vokshi përgjigjet "po".

Gazetari thotë më tej se e ka pyetur Ramën për akuzat e ngritura për çështjen. "Procedura është parë nga Komisioni European

dhe është një linjë me legjislacionin. Është partneritet publik-privat, bazuar në bashkëpunimin me pronarët privatë të tokës dhe shtetit si një tjetër pronar i tokës. Ndaj është një procedurë e qartë konform rregullave për rrethana të tilla", mbyllet citimi i kryeministrit. Gazetari thotë se nuk dihet se kur do të bëhet shembja, por protestuesit kanë thënë se do ta mbrojnë me trupat e tyre.

## REAGIMI

Pas daljes së kronikës ka reaguar edhe Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit. Përmes një postimi në faqen e tyre zyrtare në rrjetin social facebook, Aleanca e cilëson atë të BBC-së, një deklaratë e fortë:

"Në reportazhin kushtuar esk-luzivisht aferës se Teatrit, BBC e kryqëzon Edi Ramën duke e nxjerrë ndër të tjera dhe shumë qesharak:

"Ndërkohë që Presidenti i vendit dhe Kreu i Delegacionit të BE-së e konsiderojnë Teatrin një vlerë të jashtëzakonshme të Trashëgji-

## VARREZA HISTORIKE

I pyetur për Teatrin Kombëtar nga BBC, kryeministri Rama thotë se "Ne nuk mund të përballojmë të kemi këtë varrezë të historisë në mes të qytetit. Duhet të ndërtojmë një teatër të ri atje siç bëhet kudo. Jo çdo gjë e vjetër vlen të mirëmbahet". Një kompani është përzgjedhur për teatrin e ri që do të kushtojë shumë por qeveria nuk do të paguajë asnjë lek, thotë gazetari i BBC-së.

misë Kulturore, kryeministri Edi Rama, nuk e gjen ndërtesën më të vlefshme se brekët e Violeta Manushi' duke cituar një deklaratë skandalozë të Ramës në emisionin Ajsberg në vitin 2000 ku tallesh me të ndjerën Violeta Manushi- një nga ikonat e teatrit dhe skenës shqiptare", shkruan Aleanca.

Në lajmet e datës 5 mars, duke filluar nga minuta 30:20, BBC i kushton një reportazh të veçantë çështjes së Teatrit duke u fokusuar veçanërisht te problemi i "ligjit special".

Aleanca e cilëson mbrojtjen qesharake fjalën e Kryeministrit Rama që thekson se ligji është miratuar nga Komisioni Evropian. "Kjo nuk është aspak e vërtetë! Komisioni u shpreh se nuk kishin legjitimitet të vlerësonin kushtetutshmërinë e ligjit special, por se aplikimi i tij mund të binte ndesh me parimet e konkurrencës e prandaj këshillointe ndjekjen e një procedure tjetër", shton Aleanca.

## NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përmbarrimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të III (tretë), për shlyerjen e pasurisë ULLISHTË, me sipërfaqe 3.400 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 327/1, Vot. 1, Faza 221, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: Z. Bajram Suller Straci, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandi pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën 1.713.600 (një milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind) Lekë.

Ankandi do të zhvillohet më datë 12.03.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbarrimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.tel:042320227, email: gshen@tdmail.com



SHQËRIA PËRMBARRIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k

Rr. "Tish Dasa", Kompleksi Kka 2, Kulla 5, K1, 1, Tiranë

Web: www.3h.ai, Email: shqg\_3h@yahoo.com, cel:0692099711

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.28.02.2019 deri ne dt. 11.03.2019 per:

sendin e luajtshem mjeti me targe DR 9619 D

ne pronesi te Hysni Gjergji

Cmimi fillestar eshte 800 EURO

Ankandi zhvillohet ne zyrën përmbarrimore ne datën 11.03.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00

Medar KAJOLLI Permbarrues Gjyqsor Privat me seli ne Rr."Urani Pano" Pll.1/3, Kati-2, Tiranë,

nxjerr ne shiteje ne ankand pasurite e paluajtshme si me poshte;

- Nr.Regjistri Hipotekor 717, datë 12.10.2018, me Sip.-200 m<sup>2</sup>, Zk. 3844, Lloji Dyqan Shiteje

Industriale, ndodhur ne Vuno, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë, me vlerë 4.151.280 (Katër milion e

njëqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë) Lekë;

- ne pronesi te debitorit Z.Spiro Ekonomi.

Shiteja e pasurite te paluajtshme do te behet (Zhvillohet) ne date 11.03.2019, ditën e Hënë, ora 16.00

ne Zyrën e Përmbarruesit Gjyqsor Privat Z. Medar KAJOLLI, ne Adresën Rrugën "Urani Pano", Pll.-1/3, Kati-2, Tiranë.

Per informacione mund te kontaktoni

Nr.Tel:+355 66 20 333 03, ose ne Adr.-email:medar.kajolli@yahoo.com

Dje në "Deutsche Welle"

# Pse qeveritë e Ballkanit dëmtojnë ambjentin për HEC-et

Virtyt Gacaferri

(vijon nga faqja 1)

... agjendën e tyre aktivistë për mbrojtjen e lumenjve nga i gjithë Ballkani.

Personazhe të filmave dokumentarë dhe reportazheve televizive që kanë mbuluar rezistencën popullore kundër HEC-eve nga i tërë Ballkani u bashkuan në një sallë të Parlamentit Evropian. Këtu përfaqësuesit e komuniteteve dhe gazetarët bënin foto së bashku dhe këmbenin përvojat e tyre në ndaljen e HEC-eve në vendet e veta.

Maida Bilali qëndronte pranë flamurit shqiptar me pankartën e saj nga Bosnja, ku shihej mbishkrimi i vendlindjes së vet Krusica, fshati ku banorët e ndalën ndërtimin e hidrocentralit me trupat e tyre. Bilali me bashkëvendëset e veta e bllokuan rrugën për në pikën e ndërtimit 505 ditë me radhë, 24 orë në ditë. Në këtë mënyrë ato kishin ndaluar ndërtimin e HEC-eve në fahstin e tyre. Mirëpo tregon Maida "beteja nuk ka përfunduar, pasi ende nuk është tërhequr kontrata e koncesionit".

"Këtu kemi pasur një takim të rëndësishëm me Komisionin Evropian, ku kemi përcjellë rëndësinë e ruajtjes së resurseve natyrore, pasi vizioni im është që këtë pasuri ta ruaj për gjeneratat e ardhme", thotë ajo për DW.

Në Bruksel është edhe guida turistike dhe aktivisti ekologjik nga Shqipëria Alben Kola, i cili me vete kishte posterin ikonik të pro-



testës së fundit në Kosovë kundër ndërtimit të HEC-eve në shtratin e lumit Lumbradh të Pejës. Posteri me grusht të mbyllur, flamuri kuq e zi dhe simbolet boshnjake kishin mbuluar koridorin e Parlamentit Evropian. Në sallë u shfaq filmi dokumentar i Elton Baxhakut "Free Flow", ku u shpjeguan detajisht shumë probleme që janë shkaktuar nga HEC-et dhe procesi i ndërtimit të tyre.

**PSE QEVERITË E BALLKANIT UA JAPIN**

## BURIMET E VETA TË TJERËVE

Pas filmit, eurodeputeti Thomas Waitz, nga të Gjellbrit e Austrisë tha se HEC-et sjellin përfitim për disa, por shkatërrojnë potencialin për zhvillim të turizmit për tërë zonën. "Pse për të ardhurat e një kompanie energjetike austriake duhet të shkatërrohet një vend?", pyeti austriaku. "Si është e mundur që qeveritë e vendeve si Bosnja e Hercegovina, Serbia, Shqipëria, Mali i Zi, Kosova janë të

gatshme të shkatërrojnë vendin e tyre për llogari të të tjerëve? Është korrupsion", tha Waitz.

"Është Dhoma Ekonomike e Austrisë, që është po lobon për këto hidrocentrale. Unë kam biseduar me disa ambasadorë të Austrisë dhe ata janë mjaft kritikë për këto praktika. Por është edhe qeveria që lobon për këto kompani, pasi kompanitë janë të afërta me partitë në pushtet", tha ai.

Në pyetjen nëse hidrocentralet mund të ndalen dhe a ka shpresë,

Waitz tha se "disa nga ato janë ndaluar".

## KUSH I FINANCON HEC-ET

Igor Vejnoviç nga Bankëatch, një OJQ ndërkombëtare ka humtuar se kush i financon këto hidrocentrale dhe se kush përfiton prej tyre në Ballkan. Për ndryshim prej Evropës Perëndimore ku kompanitë shtetërore apo lokale i kanë ndërtuar hidrocentralet, në Ballkan të gjitha projektet janë të bëra nga kompanitë e huaja.

Ai tregoi më tej se institucionet e BE-së duhen bërë përgjegjëse për financimin e hidrocentraleve në Ballkan. Ai veçoi Bankën Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim, Bankën Evropiane për Investime si banka publike, të cilat shpesh i financojnë këto projekte përmes bankave lokale si Unikredit nga Italia dhe Erste nga Austria.

Nga ana e tij Besar Likmeta, tregoi përvojat e tij si gazetar që ka mbuluar çështjet e lidhura me HEC-et. Ai tregoi se në Shqipëri opinioni publik është plotësisht kundër HEC-eve, mirëpo te to vazhdohet të investohet, dhe arsye kryesore janë paratë. Për të vënë vulën se hidrocentralet nuk kanë të bëjnë fare me të Gjellbrën dhe mbrojtjen e ambjentit, përfaqësuesja e eF, Adria Irma Popovic-Dujmovic, tha: "Këto nuk janë projekte të gjelbra dhe nuk duhet të financohen".

Në debat u kthyçën edhe raportuesi për Shqipërisë nga Parlamenti Evropian, Ivan Jakovcic dhe Eduard Kukan nga EPP.

# BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE  
MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE  
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



Opinioni / Ditës

# Ndjesë, në gjunjë dhe gjithmonë!

Nga Lorenc Vangjeli

(vijon nga faqja 1)

... dembelizmin otoman që na është bërë shprehë dhe gjithë rrethinë mesdhetare që e kemi tatoo në AND-në tonë.

E para, një dhuratë që kemi trashëguar nga një bashkëjetesë e gjatë me ish-perandorinë me çerek hëne në flamur dhe e dyta, nga përgjumja që sjell dielli i fortë.

Ditët e festës në Shqipëri, të gjithë ndjehen nën komandën e zakonit, nën pushtetin e hallit se çfarë do të thotë fqinji dhe në detyrimin për të bërë atë që bën edhe tjetri; edhe të zgjedhin dhurata, edhe të luajnë rolin e njeriut që qesh nga lumturia!

Askush, as nuk e vë re dhe as nuk ja mer për të keq hipokrizisë që i sheh të gjithë të bashkuar nën marshin e pandalshëm të hipokrizisë njerëzore.

Në festa, ne shqiptarët bëhemi më të mirë!

Më i mirë është edhe një burrë që dridhet frikërisht nga eprori i vet në mëngjez, por trimërohet duke rrahur gruan në darkë.

Më i mirë është edhe ai që braktis prindërit apo harron nënën.

Madje edhe ai tipi që i pështyn qiellit, i bindur se çfarë nxjerr nga goja nuk do të zbrisë kurrë në tokë, në Tetë Mars ndjen detyrimin që të bëhet njeri më i mirë! Të gjithë nënshtrohen përballë traditës, sepse vazhdon pa prerë tradita me lule, me parfume, me rradhë për ar e diamantë tek Piro DuarArti apo dhe me para të thata në xhep si dhuratë.

Fatmirësisht Tetë Marsi nuk është festë.

Nuk është as hipokrizia e njerëzve me pushtet që prodhojnë keqardhje televizive për gra të dhunuara e të munduara, që i gjejnë në burgje apo në familje të këputura nga varfëria.

Nuk është as harbimi mashkullor me stripistë burra, me alkool dhe ephs pa fantazi i ca grave të tjera që u ka ecur mbroth në jetë.

Nuk është as protestë dhe dhunë kundër dhunës; nuk është as #me too" dhe #ti nuk je "alone"! Nuk është as kolovajze gërvish-tëse për burra që sillen si gra që shesin trupin për palo burra dhe as për gra që trembin burrat si hudhrat vampirët.

Është diçka krejt tjetër dhe krejt përtej kësaj pritshmërie. Është momenti për të kuptuar se revanshi i egër mashkullor i nja dy mijë e kusur vjetëve patriarkat, është një hakmarrje banale dhe e pavlerë përballë dhjetra mijëra vjetëve të tjerë, kur vërtet bota nuk ishte më e mirë, por ishte së paku më e vërtetë dhe e



drejtë. Sepse drejtohej nga instikti i pastër njerëzor dhe gratë.

Për këto dhe shumë arsye të tjera që një burrë nuk mund t'i kuptojë dot për shkak të limiteve të inteligjencës që i vendos përkatësia gjinore, Tetë Marsi duhet të jetë edhe kësaj here një ditë

burrash në një botë grash: me burra që duhet të festojnë në vetmi e heshtje dhe ditë që duhet festuar në heshtje dhe në vetmi.

Kështu duhet të ndodhë në një ditë si Tetë Marsi dhe në 364 ditët e tjera të vitit që mbeten.

Me një akt vetësakrifikimi që

duhet bërë në qetësi e me respekt të thellë.

Njëlloj si hyrja në kishë apo në xhami.

Në një ditë si kjo dhe gjithë ditët e tjera të vitit që mbeten, çdo burrë duhet të bjerë në gjunjë dhe të kërkojë ndjesë!

Edhe nëse nuk ka bërë asgjë! Edhe nëse është tërësisht i pafajshëm ai duhet ta kërkojë ndjesën në gjunjë. Dikush tjetër, një burrë si ai, me siguri ka gabuar përballë një gruaje. Dhe ai, edhe besimtari në Zot, edhe skeptiku që nuk njeh Zotin, duhet të kërkojë ndjesë edhe për atë! Ndjesë sepse është burrë! Burrë në një botë të papërkryer! Që është edhe e ligë sepse nuk është botë grash!

Javanews.al

## HOROSKOPI

### DASHI

Dikush që ka një tendencë për t'i bërë gjërat më të vështira se sa duhet të jenë, mund të transmetojë energji negative tek ti. Mos e lejoni këtë gjë edhe nëse do t'ju duhet të tregoheni pak i ashpër ndaj tij.

### DEMI

Sot do të përmbytyni nga këshillat e të tjerëve. Veproni siç ju thotë instinkti dhe mos u ndikoni nga askush. Buzëqeshni me komentet e tyre dhe pastaj ndihuni i lirë që t'i shpërfillni ato.

### BINJAKET

Një ide që keni konsideruar si një nocion radikal do të duket shumë më i arsyeshëm sot, megjithëse mund të ndryshojë jetën tuaj. Hapni mendjen tuaj dhe ndjehuni i lirë të dilni jashtë rutinës tuaj normale.

### GAFORJA

Ju mendoni se po flisni mjaft qartë, por njerëzit e tjerë mund t'ju keqkuptojnë. Në ajër ka një mjegull të ngatërruar, dhe shpjegimi i ideve të komplikuar do të jetë shumë e vështirë. Këto mosmarrëveshje mund të lindin edhe në dashuri.

### LUANI

Instinkti juaj i gjashtë po bëhet shpejt kuptimi juaj ndaj nuk duhet të hezitoni që të mbështeteni tek ai! Tani për tani vizioni juaj është i paqarte për shkak të dëshirave tuaja të shumta. Përpiqui të vini në zbatim planet tuaja në biznes.

### VIRGJERESHA

Vetëm punë dhe aspak argëtim nuk është gjëja e duhur. Mos u shqetësoni aq shumë për punën ose shkollën dhe filloni të eksploroni aspektet më romantike të jetës suaj. Përpiqui të shijoni muzikën, modën dhe artin të cilat stimulojnë emocionet tuaja.

### PESHORJA

Kur të hyni sot në një situatë të re, kujdesuni për disa njerëz që duan të marrin të gjithë kontrollin. Ata mund t'ju shohin si konkurrencë (edhe nëse nuk jeni) dhe ju japin më pak se një mirëseardhje të ngrohtë.

### AKREPI

'Thjeshtësia' është parulla e sotme. Mbani gjërat të thjeshta dhe do të keni një ditë fantastike! Në punë ose në shkollë, mos u shqetësoni me prezantime të komplikuar plot skema. Në jetën tuaj të dashurisë, mos krijoni skena dramatike.

### SHIGJETARI

Sot, do të dalë në ditë një informacion i ri dhe kjo mund të bëjë që ju të ripërkufizoni një nga vlerat tuaja. Një person pa shtyllë kurriore po lëkundet në jetën tuaj - dhe kjo do të jetë një ndjenjë e lodhshme.

### BRICJAPI

Gjetja e mënyrave krijuese për të fituar ose për të kursyer para do të jetë një sfidë e këndshme për ju sot. Gjatë muajve të ardhshëm, pasuria juaj në mënyrë mund të bëjë që disa njerëz të jenë shumë ziliqar për ju. Nëse kjo ndodh, ndani sekretet tuaja për suksesin financiar!

### UJORI

Thuhet se fëmijët kanë nevojë për disiplinë në mënyrë që të jenë të lumtur dhe të shëndetshëm, por dhe të rriturit kanë nevojë për rregullat në jetën e tyre gjithashtu! Ti e di se oia është zgjedhja e duhur, prandaj përpiqui që ta bëni atë për të arritur atje ku doni.

### PESHQIT

Lejoni ngrohtësinë tuaj të dalë në sipërfaqe në çdo situatë të vështirë dhe gjithmonë do t'ia dalësh me sukses. Çdonjëri dëshiron të qëndrojë me njerëz që i bëjnë të ndihen mirë. Prandaj largojini njerëzit negativë nga rethi juaj.

**KORÇARËT HEDHIN POSHTË DHE ZËRAT PËR TËRHEQJEN E UEFA-S**

Dita e djeshme ishte e mbushur me shumë dilema rreth të ardhmes së Skënderbeut, lidhur me çështjen e nxehtë të klubit korçar, që ka apeluar në KAS dënimin e rëndë të dhënë nga UEFA. 10 vjet pezullim nga veprimtaritë europiane dhe 1 milion euro gjobë kanë bërë që Skënderbeu të kërkojë të drejtën në KAS, ku shpreson të rrezojë UEFA-n. Ditën e djeshme, KAS-i ka publikuar listën e çështjeve në program deri më 31

**Nuk ka gjyq në KAS? Skënderbeu reagon zyrtarisht!**



maj, ku nuk figuron asnjë çështje Skënderbeu-UEFA, ndërsa më pas janë shtuar zërat për një tërheqje të UEFA-s nga kjo seancë, duke e bërë praktikisht të fituar këtë betejë ligjore. Por Skënderbeu nuk ka heshtur dhe ka vendosur t'i vërë kapak kësaj çështjeje, duke konfirmuar, nga ana e tij, se gjyqi në KAS do të zhvillohet më 16 prill. "Klubi i Futbollit "Skënderbeu" është i detyruar të sqarojë të gjithë

dashamirësit e ekipit dhe ata që duan të dinë më shumë për vendimin që ne presim nga CAS-i. Të gjitha ato që fliten së fundi në ambientet futbolldashëse, në mediat e shkruara dhe elektronike, por edhe në të gjitha rrjetet sociale janë vetëm thashetheme dhe asgjë më shumë se kaq. Jemi mësuar prej shumë kohësh me këto thashetheme dhe ne u themi të gjithë tifozëve që të qëndrojnë me "këmbë në tokë".

Të vetmet sqarime zyrtare dhe reale mund ti gjeni vetëm në faqen tonë. Ju njoftojmë se Seanca Dëgjimore në CAS do të jetë në datën 16 prill 2019 dhe sigurisht do të presim të qetë këtë ditë dhe bashkë me të edhe vendimin zyrtar. Jemi të qetë dhe të bindur që ne do të dalim fitimtarë në fund, por na vjen keq për thashethemet e fundit dhe ishëm të detyruar për këtë sqarim".

Në Kryeministri do të jetë prezente ministria Shahini dhe drejtori i policisë Ardi Veliu

**Takimi i së hënës Rama-Duka ja pikat që do të diskutohen**

*Skuadrat mund të luajnë që nga ndeshjet e Kupës*

**Trajneri i Tiranës**

**Mema: Shtyrja na ul ritmin, dënimi i Kamzës prish garën**

Tirana ka baruarar ditën e djeshme në takimin ndaj Korabit, një miqësore e zhvilluar në "Selman Stërmasi", takim që përfundoi në barazim 1-1. Natyrisht që Memë kjo sfidë i ka shërbyer për të testuar lojtarët, ndërsa për "Supersport", Mema u shpreh dhe për çështjet e nxehta të kampionatit tonë.

**Shtyrja e kampionatit si ndikon në Tiranë?**

Na e ulim disi ritmin, të paktën me atë çfarë treguan kundër Partizanit. Gjithsesi duhet të përgatisim ekipin për vazhdimësinë sepse na presin ndeshje shumë të vështira.

**Si e zgjidhët çështjen e arbitrit të ndeshjes?**

Ishte një zgjedhje momentale, pasi arbitrat nuk pranuan dhe kishin të drejtë. Ky takim ishte më shumë si shtërvitje, pasi aktivizova shumë lojtarë. Sfida e radhës është ndeshja e kupës me Laçin. Do të jetë një ndeshje shumë e fortë, por kemi problem se jemi pa tifozë. Është ndeshje kupe dhe duhet ta përgatisim shumë mirë. Nuk duhet të pësojmë gol dhe të fitojmë ndeshjen në Tiranë, që të shkojmë të qetë në transfertë. Mendojmë që të mos pësojmë gol, pasi është ndeshje me specifike të veçantë, sepse goli në transfertë na ndëshkon shumë.

**Si paraqitet gjendja me dëmtimet?**

Po merremi me programe individuale me disa lojtarë. Kemi nevojë për lojtarë. Bisedova me Oduamadhin dhe Sentamunë. Duhet t'i përgatisim sa më shpejt. Dy fjalë për dënimin e Kamzës Ky dënim e prish garën. Kundërshtarët tanë direkt kanë marrë nga gjashtë pikë. Gjithsesi ne duhet të merremi me ndeshjeve tona, pasi Tirana ka mundësi të ngjitet me sipër. Ndeshjet duhet t'i marrim hapë pas hapi.

**Dy fjalë për dënimin e Kamzës...**

Ky dënim e prish garën. Kundërshtarët tanë direkt kanë marrë nga gjashtë pikë. Gjithsesi ne duhet të merremi me ndeshjeve tona, pasi Tirana ka mundësi të ngjitet me sipër. Ndeshjet duhet t'i marrim hapë pas hapi.



Jeton Selimi

Futbolli duhet të rikthehet në normalitetin e tij! Topi duhet të nisë të rrotullohet për mijërat e tifozëve anëmbanë vendit, për investimet e skuadrave, për lojtarët, gjyqtarët madje dhe zyrtarët. Ndaj, që çdo gjë të bëhet funksionale, që normaliteti të mos çenohet më, duhet arritur në një marrëveshje për të mirën e të gjithëve.



ndryshimin e ligjit të sponsorizimeve, ku futbollit të ketë përfillime nga taksat. Pika e dytë ka të bëjë me ndryshimin e kodit penal, shkeljet në stadium, invadimin i fushës etj, të cilat tashmë duhet të ndiqet edhe penalisht për të minimizuar aktet e dhunës. Dhe pika e tretë është edhe ajo më e debatuar kohët e fundit, rishikimi i ligjit të sportit dhe rikthimi i policisë në stadiume.

Natyrisht që pikat do të diskutohen, por burime si nga Federata Shqiptare e Futbollit, ashtu edhe nga Kryeministria, bëjnë me dije se që ditën e hënës pritet një akord, i cili do të lejojë më në fund që të shkëlmohet topi nga mesi i fushës që në ndeshjet e së mërkurës për Kupën e Shqipërisë.

Vullneti është. Kjo u kuptua dje pas takimit mes kreut të qeverisë Rama dhe presidentit të FSHF-së, Armand Duka, një takim që u zhvillua në kryeministri dhe ditën e hënës do të pasohet nga një tjetër, më i rëndësishëm dhe që synon

të vendosë pikat mbi "i". Federata do t'i parashtrijë tre kërkesa kryeministrit Rama, në një takim të nivelit të lartë ku ndër të tjera do të jetë prezente dhe ministria e linjës, ajo e Sportit, përfaqësuar nga

ministria Besa Shahini, por edhe Policia e Shtetit, me Drejtorin e Përgjithshëm Ardi Veliu. Gazeta mëson ekskluzivisht tre pikat që federata do t'i kërkojë kreut të qeverisë. Pika e parë ka të bëjë me

**E konfirmon avokati**

**Maradona ka edhe tre fëmijë të tjerë në Kubë!**

Avokati i Diego Armando Maradonës ka bërë me dije se klienti i tij do të njohë zyrtarisht tre fëmijë të lindur në Kubë. Matias Morla, avokati i "Pibe de Oro", sot trajneri i klubit meksikan të Dorados të Sinaloas, ka folur për një televizion argjentinas, duke theksuar se tre



janë fëmijët, fryt i dy marrëdhënieve të ndryshme të Maradonës. I pyetur nëse Maradona do t'i njohë ligjërisht fëmijët e tij kubanezë, Morla është përgjigjur: "Sot ende jo, por do të kujdeset për ta dhe do të bëjë atë që duhet të bëjë. Kur të kthehet në ishulljavën e ardhshme, Diego do të nënshtrohet analizat e ADN-së dhe më pas do t'i njohë fëmijët, nëse vërtetohet që janë të tjtë". Maradona ka dhe pesë fëmijë të tjerë, Dalma e Xhanina, nga martesat me ishgruan Klaudia Vilifane, Diego jr. Jana dhe Diego Fernando.

**Post-eliminimi**

**PSG, Di Maria dhe Kavani drejt largimit**


Dështimi i radhës në Champions rrezikon të krijojë viktima të famshme rrotull "Parc des Princes" dhe më konkretisht në shtëpinë e Paris Sën Zhërmenit. Sipas të përditshmes spanjolle "Sport", padroni i klubit parizien, Naser Ghanim Al-Khelaifi, ka ndërmend të largojë

dy emra big në merkaton verore. Bëhet fjalë për argjentinasin Angel Di Maria, që kundër Mançesëter Junajtidit në 1/8-at e finaleve të Ligës së Kampioneve, ishte ndër më të mirët në fushë, dhe për uruguajinin Edision Kavani, që u la në stol në fillim të ndeshjes dhe u aktivizua nga trajneri



Tomas Tushel në pjesën e dytë. Dy lojtarët amerikano-jugorë janë me vullnet në dorë dhe do të largoheshin me ardhjen e ofertës së duhur, ndërsa Al-Khelaifi do të mendonte për afrimet e tjera.

### Fjalëkryqi (1)



**HORIZONTAL**

1. Pupi regjisor.
5. Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve
11. Turner aktore.
12. Fillojnë festat.
13. Skuadër greke.
14. Falen pa fe.
15. U shkrua nga Gorkij.
18. Një sferë për... model.
19. Janë bisha.
22. Parashitesë për dy.
23. Demoni që persekutonte Sarën.
24. Stacion i famshëm orbital.
25. Mendes regjisor.
27. Një rreth i ngushtë miqësor
29. Film me Robert de Niro dhe Jean Reno
30. Këndohen në opera.
32. Eshhtë lajm i vjetër.
34. Sharif aktor.
35. Martin i Norma Rae.
36. Mund të jenë filmi.

38. Një jepet për hartim.
39. Ami i Maupassant.
41. Fundi i Turandot.
42. Halli këngëtare.
45. Neill i Jurassic park.
47. Pineda e Garcia Lorca-s.
48. Giorgio stilist

**VERTIKAL**

1. Morisette këngëtare.
2. Kilmer aktor.
3. Heche aktore.
4. Fillojnë tatëpjetën
5. Eshhtë diapozitiv shumë i ndjeshëm.
6. Mbyllin spitale.
7. Në krye të masave.
8. Bëjnë shirit me shi.
9. Qe vajza e Tantalit.
10. Janë më shumë se dëshira
12. Ishte dekret i sulltanit.
15. Qe mbreti i urtë i Pilos.
16. Quinn aktor.
17. Gasol i NBA.
20. Fillojnë garën.
21. Një pjesë e reformave.
26. Eshhtë si biskotë.
28. Mund të jetë karmelitan.
29. Sjellin shi.
30. Bel i Maupassant.
31. Direk pa ekstreme.
33. Gjysma e bimëve.
34. Mbyllin një motor.
36. Eshhtë bitum.
37. Fara këngëtare.
38. Hanks aktor
39. Stiller aktor.
40. Morrison rockstar.
42. Fillojnë masat.
43. Në krye të tabelës.
44. Derisa janë në fund.
46. Fund filmi.

### Fjalëkryqi (2)


**HORIZONTAL**

1. Film i hitchock.
6. Fillojnë premierën.
7. Janë legjendat.
11. Kush ka... ka zët.
12. Thurman aktore.
15. Një pjesë e testamentit
16. Një pjesë e studimeve.
18. Kështu është situata e tensionuar.
21. Telefoni në kartëvizitë.
22. Eshhtë ngasje.
24. Në krye të autoriteteve.
25. Mbyllin mbledhjen.
26. Pason abetaren.
28. Nisin nga kreu.
29. Fillojnë aafirimin.
30. Cocker këngëtar.
31. Bartok kompozitor.
33. Tiriac që qe tenist.


35. Oxa këngëtare.
36. Kalimi në ekstreme.
37. U shkrua nga Zola.
39. Fise pa fe.
40. Eshhtë mballomë.
41. I mungon apatikut.
43. Një pjesë e medaljeve.
44. Një këngëtar lirik.
46. Pak torturuese.
48. Ka privilegjin e jetës.
51. I famshmi Pacino.
52. Nasi shkrimtar.
53. Janë temperaturat më të ulëta.
54. Me pit në box.

**VERTIKAL**


1. Janë enigmatikë.
2. Emri i Vivaldit.
3. Rrjedh në Klepsidër.
4. Inicialet e Selleck aktor.
5. Fillojnë rubrikën.
6. Ishte babai i Prokhit dhe Filomelës.
8. Vitet pa kufij.
9. Mbyllin kanate.
10. U shit për një pjatë thjerza.
13. ... e shëndoshë në trup të shëndoshë.
14. Moore aktore.
17. Rocca aktore.
19. Janë përmasa.
20. Fund dhjetori.
23. Mbyllin krahum.
26. Fillojnë kalimin.
27. Duhet ruajtur.
32. Ishte Europa komuniste.
34. Agjenci Kombëtare Lokale
38. Berg kompozitor.
40. Të parat në Amsterdam.
42. Elsa këngëtare.
45. Memoria në computer
47. Me të nxjerrin trarë.
49. Në mes të dhomës.
50. Ekstreme kateti.
52. Kufijtë e lutjes.



### Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

### SUDOKU

4		9				7			5
		2	1		3		4	6	
2				1		3			9
			5				1		
3			7			5			6
	7	2			6		3	9	
1		3				8			4

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	7	2	6	4	5	8	9	3
8	9	5	7	2	3	1	4	6
3	4	6	8	1	9	5	7	2
9	8	3	5	6	1	7	2	4
4	6	1	9	7	2	3	5	8
5	2	7	3	8	4	6	1	9
6	3	4	1	9	7	2	8	5
7	5	9	2	3	8	4	6	1
2	1	8	4	5	6	9	3	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

### Argëtim filozofik

- Ndonjëherë thjesht duhet të shikoni prapa në të kaluarën dhe të buzëqeshni për sesa larg keni shkuar.

- Vetëm kur të fillojmë të jemi zgjuar, kuptojmë sesa të fjetur ishim.

- Në përpjekje për të bërë të tjerët të lumtur, kam harruar veten time !!!

\*- Ka fjalë që lotojnë dhe lot që flasin ...

\*- Shiu bie kur retë nuk mund të mbajnë më peshën ...  
Lotët bien kur zemra nuk mund të mbajnë më dhimbjen.

### KRIPTOSKEME

### KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	11	18	3	10	18	2	1	15	20
3	2	6	5	3	2	1	5	1	13	1
21	4	3	5	6	2	1	5	5	10	5
1	6	10	1	2	8	11	6	4	1	5
2	13	7	2	1	5	1	1	2	8	10
19	1	7	3	5	6	15	14	10	6	A
13	3	5	2	5	6	11	1	1	1	5
5	2									E
1	5	7	6	2	8	5	10	8	6	
16	5	7	5	17	6	5	1	6	21	6
6			15	8	5	1	5		18	3
4	5	18	8	7	6	18	6	4	6	7

A	P	A	P	E	K	E	N	D	E	T
D	I	A	B	E	T	I	D	E	T	I
R	A	K	L	K	A	P	E	L	E	T
F	E	N	I	M	O	R	E	T	R	
F	E	K	O	N	O	M	I	A	D	
R	A	T	A	K	E	M	E	T	P	E
A	N	T	E	N	A	A	T	A	A	B
N	A	N	T	E	S	T	L	A	R	A
K	N	E	I	I	L	I	R	E	T	
I	B	A	N	A	K	A	E	T		
B	A	R	I	A	L	E	T	N	E	D
E	B	A	S	T	I	A	F	A	T	I

- Sa më shumë që shqetësoheni për atë që të tjerët mendojnë për ju, u përkisni atyre. Vetëm kur nuk keni nevojë për miratimin e tyre mund t'i përkisni vetes.
- Dasheduria jonë është si era, nuk mund ta shoh, por mund ta ndiej.

- Duhet të shohësh dhe të dëgjosh, por dhe të dish të heshtësh.
- Disa njerëz janë si retë, kur zhduken ... dita bëhet më e bukur!!!

### Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

D	A	V	I	D	R	O	C	K	L	R
E	M	E	R	K	E	A	S	E	A	N
M	A	L	O	T	K	E	N	E	F	A
I	N	N	I	M	R	O	M	A	N	E
R	R	P	A	S	I	V	E	T		
M	O	K	A	S	T	A	N	I	D	E
E	M	I	R	A	T	I	A	V	A	T
S	T	A	N	E	A	T	O	M	I	K
A	R	S	T	R	E	T	E	O	D	
R	A	S	E	M	I	K	O	R	E	
A	T	A	K	A	T	I	D	A	R	
H	S	T	A	R	S	I	R	T	A	R
B	A	L	E	N	A	N	M	O	T	I
E	N	K	A	G	A	I	U	M	A	
K	I	M	I	K	R	K	A	R	A	T
I	T	P	A	L	E	T	L	I	R	I
M	A	T	P	E	T	A	L	E	T	M
I	M	A	K	E	T	E	K	O	T	
K	A	L	K	E	T	I	M	E	T	K
M	U	L	E	R	M	E	T	A	L	E
A	N	B	E	T	A	M	R	P	O	T
N	A	I	F	P	I	E	I	D	E	
E	T	J	E	M	I	N	A	T	O	R
T	I	T	R	E	N	I	A	F	A	T

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



